

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7682 E mërkurë 17 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Ditëve të fundit në Kosovë është rihapur debati për stilin arkitektural të xhamisë së re të madhe të Prishtinës. Me sa duket me insistimin ...

Vijon në faqen 20

Nga ADRI NURELLARI

Xhamia që meriton Prishtina dhe rreziku i përsëritjes së gabimit të Tiranës



Opinion

Ditës

Nëse do të rregullohej puna e shpifjes me paketë, do t'ia vliente të paguanim edhe një taksë nëse, na premtohet jeta në një ambient ku nuk ka shpifje ...

Vijon në faqen 21

Nga LUTFI DERVISHI

Shpifja, beteja e gabuar!



Albert Gega është dënuar me 10 vite burg

Tragjedia e Butrintit me 5 të vdekur, arrestohet pas 10 vitesh trafikanti

Nëna e njërit prej viktimave: Djalin ma morën, i vunë pistoletën në kokë

ERVIS KUÇI

FIER - Një prej organizatorëve të tragjedisë së Butrintit është arrestuar pas 10 vitesh nga policia e Fierit. Bëhet fjalë për 36-vjeçarin Albert Gega nga fshati Kurjan, i cili është dënuar me 10 vite burg nga Gjykata ...

Në faqen 6

KRYEMINISTRI NE "NEWS 24": GJATE MANDATIT TE PARE S'PATEM MAZHORANCE

KAZINOTE, RAMA: LEJOHEN VETEM NE ZONA TURISTIKE

“Ndryshimet në qeveri janë puna ime, i pakënaqur nga vetja. Nëse do dënohej shpifja, shumica e gazetarëve do ishin në burg”



(Në foto) Kryeministri Edi Rama, dje gjatë intervistës në emisionin "Dritare" të gazetares Rudina Xhunga, në "News 24"

Në faqen 4-5

KREU I OPOZITES

Helimi ndaj Ramës për "Babalen", Basha: Kësaj drejtësie do t'i vijë fundi shpejt

Në faqen 3

VIZITA

Meta pret Princin e Monakos, Alberti II: Nxitje biznesit të investojë në Shqipëri

Në faqen 3

SKEMA E PENSIONEVE

Të vetëpunësuarit në bujqësi do të paguajnë më shumë sigurime

Në faqen 9

VENDIMI I QEVERISE

Qendra historike e Tiranës, një VKM për zonën e mbrojtur

Në faqen 19

RAPORTI I QENDRES 'VATRA'



Trafikimi, viti 2017 thyen rekordin, 59% e viktimave janë shfrytëzuar seksualisht

Në faqen 10

Zv.rektorja Anni Dasho Sharko: Së shpejti vijmë me akademitë Cisco dhe Mikrosoft

"Luarasi", bashkëpunim me akademinë Mikrotik për teknologjinë

“Studentët tanë janë më afër tregut të punës e bizneseve”

Nga VOLTIZA DURO

Universiteti "Luarasi" vazhdon të surprizojë me risi dhe bashkëpunime të fuqishme me kompanitë më prestigjioze në tregun e punës. Në Fakultetin më të ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, studentët e vitit të parë në



nivelin bachelor janë njohur me akademinë Mikrotik. Kjo akademi do të ofrojë kombinimin e teorisë me praktikën si dhe qasjen e studentëve me bizneset që operojnë në fushën e teknologjisë. Dritan Vreshta, administrator në një prej kompanive në ...

Në faqen 11

PADITË PËR SHPIFJET REAGIMET

E quajti "bandë e Berishës", Sali Lushaj padit kreun e grupit të PS

Balla: Sot, kallëzim të plotë për Bashën, Saliانjin dhe Hoxhën

"Lulzim, mos kërko marrëveshje për t'u tërhequr nga paditë"

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje se sot do të bëjë një tjetër kallëzim të plotë për vepra penale të kryera në bashkëpunim për Lulzim Bashën, Ervin Saliانjin dorë për dorë me Florenc Hoxhën. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Balla tha: "Lulzim Basha është zyrtarisht në hetim për 'kallëzim të rremë të kryer në bashkëpunim' me shpifës Nuhun. Pse nuk shkoni PD t'i shohë kamerat e komisaritit dhe praninë time në komisariatit e Fushë-Krujës, apo edhe të vetë Nuhut? Ti Lulzim si person në hetim ke të drejtë t'i shohësh. Apo hajt se do harrohet. Nuk e lë unë në harresë, Lulzim! Sepse dje turpërova Shqipërinë, aspak mua, me një paçavure që i dhe të lexojë Pollua", u shpreh Balla. "Edhe Ervin Saliانji është zyrtarisht në hetim bashkë me 'Babale&co'. Nesër (sot), tek Prokuroria e Krimeve të Rënda depozitoj kallëzim të plotë për vepra penale të kryera në bashkëpunim për Lulzim Bashën, Ervin Saliانjin dorë për dorë me Florenc Hoxhën, pazarxhinjtë e sëmurë, që ranë brenda në kurthin që ngritën vetë me ca personazhe qesharakë e që nuk ka alibi që i shpëton", bëri të ditur kreun e grupit parlamentar të PS-së. Duke iu drejtuar kreut të PD-së, Balla tha: "Ti Lulzim duhet të sqarosh pazaret me këta persona, të bëra në SHQUP apo në oborrin e SHQUP-it. Kallëzimi dhe çdo informacion tjetër është në dispozicion të prokurorisë, sepse shqiptarët duan të dinë të vërtetën sa më shpejt. Luli kërcen nga një degë në një degë, nga një gënjeshtër në tjetrën. Turp s'ka". "Lulzim, mos kërko marrëveshje për t'u tërhequr nga kallëzimet. Do t'i shkojmë deri në fund secilës prej shpifjeve", nënvizoi Balla.

PADIA E LUSHAJT

Ndërkohë dje, Sali Lushaj ish-turpuroja i Sali Berishës paditi në Gjykatën e

Tiranës deputetin e Partisë Socialiste, Taulant Ballën. Mësohet se Gjykata e Tiranës ka depozituar padinë e Lushajt. Ky veprim vjen pas deklarats së kreut të

grupit parlamentar të PS-së, Balla, i cili tha se Lushaj ishte pjesë e "bandës së Berishës". Lushaj kërkon dy milionë lekë të reja dëmshpërblim nga Balla. Në një

video të publikuar për çështjen "Babalja", deputeti i PD-së, Ervin Saliانji paraqiti sipas tij bisedën mes Sali Lushajt dhe Fredi Alizotit, bisedë në të cilën implikohej emri i Ballës. Kaq mjaftoi që socialisti të "shpërthente" në akuza ndaj Lushajt. Balla e ka vënë në qendër të sulmeve të tij Lushajn edhe herë të tjera, kur ky i fundit ishte pjesë e një proteste të organizuar nga PD në dhjetor të vitit të kaluar, duke e cilësuar atë si njëri të besuar të Berishës.

GENC POLLO

Deputeti demokrat pranoi që shërr i bërë në PE ditën e hënë ishte i pakëndshëm. "Këtu mund të biem dakord, sepse qoftë të ngresh akuza personale, qoftë ta bësh këtë në një kontekst europian nuk besoj që në vetvete i pëlqen njeriu", tha Pollo. Sipas tij, eurodeputetët po kërkojnë informacion për Ballën.



Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

"Kjo qeveri, faqja më e zezë e Shqipërisë"

Sherri në PE, Rama nxori mesazhin e eurodeputetit, Paloka: Ju jeni turpi

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka reagoi dje pas mesazhit të një eurodeputeti që publikoi kryeministri Edi Rama në "Facebook", lidhur me situatën e krijuar një ditë më parë në PE. Paloka u shpreh se turp është që Rama nuk gjen dot një ministër Rendi të palidhur me krimin dhe një deputet, që nuk është shërbëtor i krimit për të përfaqësuar PS-në në BE. "Rama vazhdon me propagandën bajtate se opozita po nxin dhe turpëron Shqipërinë". Është vërtetë turp për Shqipërinë. Turp që Tahiri, Xhafaj e së fundmi Balla diskutohen në kancelaritë e BE-së si



shembuj të qartë se si qeverisja e Edi Ramës është vënë në shërbim të krimit dhe jo të interesave të shqiptarëve për të ecur përpara me reformat drejt Evropës", u shpreh dje Paloka. "Turp që Rama nuk gjen dot një ministër Rendi të palidhur me krimin. Turp që nuk dëshiro-

ron të gjejë një deputet, i cili nuk është shërbëtor i krimit për të përfaqësuar PS në BE. Edvin Rama dhe qeverisja e tij janë faqja më e zezë e Shqipërisë post-komuniste dhe opozita ka detyrimin t'i shpëtojë shqiptarët nga kjo", tha më tej Paloka. Më herët kryeministri Rama shkroi në "FB": "Një mik i Shqipërisë në Parlamentin Europian: I dashur Edi! Skam dashur kurrë të deçoj qadëq ka deçojta sot për çka kishin bërë kolegët shqiptarë! Është e tmerrshme dhe e padëgjuar nën çatinë e BE-së! Jam pa fjalë dhe uroj të gjeni forca e kurajë për të vijuar punën por me ata...".



Gjatë një seance parlamentare

BALLA

"Lulzim Basha është zyrtarisht në hetim për 'kallëzim të rremë të kryer në bashkëpunim' me shpifës Nuhun. Pse nuk shkoni PD t'i shohë kamerat e komisaritit dhe praninë time në komisariatit e Fushë-Krujës, apo edhe të vetë Nuhut? Ti Lulzim si person në hetim ke të drejtë t'i shohësh. Apo hajt se do harrohet. Nuk e lë unë në harresë, Lulzim!"



Saliانji, Ballës: Në prokurori jepet llogari, nuk shpëlahen krimet

Deputeti i PD, Ervin Saliانji ka ironizuar kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla pas njoftimit të këtij të fundit se sot do depozitojë një tjetër padi në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Balla tha se kreun e PD-së, Lulzim Basha është nën hetim për kallëzim të rremë të kryer në bashkëpunim me ish-oficerin që denoncoi çështjen "Xhisiela", Emiljano Nuhu, ndërsa Saliانji shprehet me ironi se prokuroria është vendi ku jepet llogari për krimet dhe jo faltore për shpëlarjen e krimeve. Deputeti i PD ka publikuar edhe një foto ku shfaqet Balla me Edmond Begon, ky i fundit sipas opozitës është dënuar në Itali për trafik droge. "E ke ngatërruar Taulant! Prokuroria është vendi ku jepet llogari për krimet, jo faltore për shpëlarjen e krimeve! Kështu jemi ndarë, ne japim llogari për denoncimin e krimit, ju jeni të ngrehur nga lidhjet me krimin!", u shpreh dje Saliانji.

Ballë

Kreu i PD-së, Lulzim Basha është nën hetim për kallëzim të rremë të kryer në bashkëpunim me ish-oficerin që denoncoi çështjen "Xhisiela", Emiljano Nuhu.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i dorëzoi dje në shenjë vlerësimi dekoratën e "Flamurit Kombëtar" Princit të Monakos, Alberti II. Gjatë ceremonisë në "Pallatin e Brigadave", Presidenti Meta tha: "Kjo është dekorata më e lartë, me të cilën ne shqiptarët nderojmë e respektojmë miqtë tanë më të mirë. Mirënjohje të veçantë për njohjen e shtetit të Kosovë", tha Presidenti Meta. Z. Meta vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit konkret, në fushat ku eksperiencia dhe ekspertiza e Monakos është shumë e njohur ndërkombëtarisht, si në turizëm e në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e ekonomisë së gjelbër, inovacion e teknologjinë, në shërbimet financiare, trajnimin profesional e në fusha të tjera me interes. Kreu i Shtetit kërkoi gjithashtu nxitjen e biznesit të

Presidenti i Republikës e nderon me dekoratën e "Flamurit Kombëtar"

Meta pret Princin e Monakos, Alberti II: Nxitje biznesit të investojë në Shqipëri



Monakos që të eksplorojë dhe investojë në tregun shqiptar. Më herët, Presidenti Meta e priti Princin e Monakos në një takim të veçantë, ku pjesë ishte edhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Kreu i shtetit kërkoi gjithashtu nxitjen e biznesit të Monakos që të eksplorojë dhe in-

vestojë në tregun shqiptar. Duke iu referuar përkatësisë mesdhetare të të dyja vendeve, Presidenti Meta dhe Princi Albert II i Monakos nënvizuan nevojën e rritjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së ambientit dhe të biodiversitetit. Presidenti Meta

shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Fondacioni Princit të Monakos dhe Shoqata për financim të qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura Detare në Mesdhe po u japin strukturave dhe shoqatave përgjegjëse shqiptare për mbrojtjen dhe promovimin e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura detare shqiptare. Në fund të bisedimeve zyrtare, në praninë e të dy kreëve të shteteve u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi nga ministrit e Jashtëm të të dy vendeve, me anë të së cilës palët bënë dakord të identifikojnë fushat e veçanta të bashkëpunimit dhe të promovojnë më tej ato.

Kreu i opozitës: Prokuroria lëshoi lajmin se Tahiri e ka të ligjshëm luksin ku jeton

Hetimi ndaj Ramës për "Babalën", Basha: Kësaj drejtësie do t'i vijë fundi shpejt

"Në Shqipëri dy drejtësi, një për Ramën, një për kriminelët"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha tha dje se kësaj drejtësie do t'i vijë shumë shpejt fundi. Në një reagim të tij pas vendimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda për të mbyllur hetimin ndaj kryeministrit Rama kërkuar nga opozita për audiopërgjimin e Babales, Basha tha se drejtësia veprimi me dy standarde. Sipas Bashës, në Shqipëri vepron 2 drejtësi, një për kriminelët dhe një për popullin. "Prokuroria ka refuzuar të hapë hetimet për Edi Ramën, edhe pse ai mashtroi publikisht se kishte bërë ekspertizë private të audiopërgjimit, me qëllim të qartë që të mbronte një kriminel dhe për të ndikuar dhe kërcënuar organet e drejtësisë që të mos hetonin. Gjithashtu, sot (dje), prokuroria ka refuzuar të marrë nën hetim Ardi Veliu dhe Taulant Ballën. Po (dje) sot, prokuroria ka lëshuar përmes mediave të pushtetit lajmin se Saimir Tahiri e ka të ligjshëm gjithë luksin në të cilin jeton", u shpreh kreu i PD-së. Sipas Bashës, "është e njëjta prokurori që burgosi kuksianët, që burgosi përditë njerëzit e thjeshtë



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

për shkeljet më të lehta, që heton gazetarët kritikë dhe kundërshtarët politikë". Për kreun e opozitës, "në Shqipëri janë vendosur dy drejtësi: një për Edi Ramën dhe kriminelët dhe një tjetër për popullin. Edi Rama dhe kriminelët janë mbi ligjin,

kurse mbi popullin ushtrohet dhunë duke abuzuar ligjin. Kësaj 'drejtësie' do t'i vijë fundi shumë shpejt! Kallëzimi i opozitës për Ramën lidhet me deklaratën e kryeministrit në muajin maj pas publikimit të audiopërgjimit të Albert Velikut.

Rama tha nga selia e PS se e kishte marrë përgjigjen e audiopërgjimit dhe nga ekspertiza kishte konstatuar se audioja ishte e montuar. Petrit Vasili dhe Edmond Spaho depozituan më 11 korrik një kallëzim në prokurori për Ramën, ku e akuzonin se kishte kryer veprën penale të "Veprime gënjëse të zbulimit e të vërtetës". Në vendimin e prokurorisë për të mos filluar hetimet thuhet se kryeministri Edi Rama nuk ka kryer veprën penale dhe se mungojnë elementët për këtë veprë.

Shoqëria permbarimore JUSTITIA

Shpall ankandin, faza para, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:
 Apartament me nr.pas.7/21+1-4, zk.8360, vol.26, fq. 204, me sip 138.40 m², Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKU

Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 116.256 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dy qind e pesëdhjetë e gjashtë) EUR.

Ankandi zhvillohet në datën 01.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

SHKURTE

Haradinaj: S'ka ekstradim të "Babales" pa kaluar etapat ligjore

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është pyetur gjatë vizitës së tij në Tiranë për mundësinë e ekstradimit nga Kosova të Albert Velikut i njohur si Babalja, i cili shfaqet në audiopërgjimin e pretenduar ndaj vëllait të ministrit Fatmir Xhafaj. Ramush Haradinaj tha se pa kaluar të gjitha etapat ligjore, nuk ka ekstradim të Albert Velikut. "Tek ne në Kosovë pushtetit janë të ndara. Pra, është shumë e vështirë për mua që t'u them sot a i është drejtuar ai institucioneve të Kosovës. Politika informohet vetëm kur një gjykatë ka marrë një vendim për ekstradim dhe atë vendim duhet që ta aprovojë një ministër. Kur vjen aprovimi i ekstradimit nga gjykata tek ministri i Drejtësisë, atëherë hyn politika. Deri atëherë është rast ligjor dhe nuk ndërhyr dot ekzekutivi. Rasti i shtetasve turq të deportuar nga Kosova ka qenë një mësim i marrë me pasojat e veta kuptohet, por ajo ka ndikuar që të respektohet mjaftueshëm kreu baze ligjore për procedurën në fjalë, pra kërkesa për azil për strehim ose për mbrojtje", - tha Ramush Haradinaj.

Kallëzimi i opozitës, Vasili: Prokuroria iu dorëzua krimit

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, njoftoi dje vendimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për të mbyllur çështjen në ngarkim të kryeministrit Edi Rama për audiopërgjimin e "Babales". Vasili dhe Spaho nga PD depozituan pak kohë më parë një padi kundër kryeministrit Edi Rama, me anë të të cilës kërkuan hetim penal ndaj Ramës, pasi sipas tyre ka fshehur të vërtetën për dosjen "Babalja". Përmes një postimi në "Facebook", Vasili thotë se prokuroria i dorëzohet përfundimisht krimit dhe i mbyll çështjen Ramës. "Prokuroria i dorëzohet përfundimisht krimit dhe i mbyll çështjen Edi Ramës. Prokuroria e dorëzuar kokë e këmbë te krimi dhe që pacipësisht dënon me arrest gazetarët që denoncojnë të vërtetat e mëdha. Prokuroria që thërrret kryetarin e Partisë Demokratike për çështje ordinere. Prokuroria që mbulon provat në audiopërgjimin e Agron Xhafajt. Sot prokuroria pas kallëzimit të opozitës ndaj Edi Ramës, që gjoja kishte kryer ekspertizën e audiopërgjimit ia mbylli pacipësisht çështjen. Gazetarët në burg, Edi Ramës i mbyllet çështja", u shpreh Vasili.

KREU I QEVERISE INTERVISTA

Kryeministri: Gjatë mandatit të parë nuk patëm mazhorancë

Bastet, Rama: Një mortije, do lejohen vetëm në zona turistike

"Shpifja, nuk e harroj djalin duke qarë poshtë krevatit"

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje i prerë se nuk do ketë më baste në asnjë vend. Ai tha se do mbyllen të gjitha dhe do të lejohen vetëm në zonat turistike dhe në hotele me 5 yje. Gjatë intervistës në emisionin "Dritare" të gazetares Rudina Xhunga, në "News 24", kryeministri Edi Rama deklaroi se 95 përqind e atyre që kanë luajtur baste deri tani, pas 1 janarit të vitit të ardhshëm nuk do të kenë më mundësi për të luajtur. Teksa ka folur në "Dritare" në "News 24", Rama theksoi faktin se për lojërat e fatit 'online' do të kenë një fazë të dytë vlerësimi, ku do të ketë rregulla përkatese.

Keni deklaruar edhe më parë për mbylljen e lojërave të fatit. Këtë herë mundëni t'i mbyllni të gjitha?

Kjo ka qenë një përpjekje e nisur më parë, e cila u materializua në një tentativë në parlament për kazinotë elektronike. Në atë kohë nuk u diskutua për bastet, por kazinotë elektronike. Atë kohë dështoi. Nuk u fut menjëherë. Ka pasur disa interpretime për këtë, jo do ikin nga qendra, do shkojnë në periferi. Do mbyllen të gjitha dhe do ketë të tilla vetëm në zona turistike dhe në hotele me 5 yje. Do ikin nga kudo. Është një mortije që është kudo.

Bastet do ikin nga Tirana dhe ku do shkojnë?

Ne kemi marrë një sërë masash dhe kompanitë janë përgjysmuar, ndërsa të ardhurat janë rritur, por ka ende infomalitet dhe burime kriminale. Do mbyllen të gjitha.

Po monopolizohen dhe nuk po mbyllen.

Ne do punojmë për regjimin e ri të basteve 'online'. Kemi ngritur një grup pune dhe në 31 dhjetor do mbyllen të gjitha, duke përfshirë edhe këtë monopolin 'online'. Do kemi një garë të hapur për këtë treg. Kam parë shumë përpjekje se do intensifikohen. Po i heqim miliardat krimi të organizuar. Një pjesë janë kompani



Kryeministri Edi Rama

ku fshihet një segment i krimi të organizuar. Më shumë se 95% e atyre që luajnë, nuk do luajnë më pas mbylles.

Tek 'online' është një gjë, e cila nuk mund ta bëjë kushdo. Por, duhet kartë identiteti, kartë bankare, por fondet vijnë nga bankat. Taksimi i lojtarit fitues, është i taksueshëm. Më shumë se 95 përqind e atyre që kanë luajtur, tashmë nuk do të kenë kohë për të luajtur. Më 1 janar do të mbyllen të gjitha.

Thonë që e ka Olsi Rama, Vangjush Dako, dalin emrat e "Bastarena".

E gjitha kjo forco për të thënë se e ka vëllai është përpjekje për të hedhur balatë. Nga 1 janari nuk do të ketë pika bastesh, por pjesa që i intereson edhe publikut, po mbyllet kompanitë poshtë pallateve, e poshtë dyqaneve. Në një treg normal ka një ligj, i cili ka disa rregulla konkrete. Kur shteti nuk i kontrollon dot, vjen ky ligj, merret vendimi drastik për ta mbyllur tregun. Nga 1 janari e tutje ata që e kanë mikrob lojërat, do të gjejnë forma të reja për të vënë bastet. Në 2016-ën nuk kishim mazhorancë. Gjatë mandatit të parë nuk patëm mazhorancë, kjo është një industri me influencë shumë të madhe. Unë e di se edhe ju si në të gjithë botën jeni. Hedh shumë para, lobon mbi deputetët dhe mbi mediat, por edhe me shpifjet, ku është vëllai, etj. U shty pasi nuk

patëm dot vota. Kam pasur debate të brendshme për këtë. Për sa i përket asaj se kjo bëhet se s'ka shtet që të kontrollojë apo si masë për të bërë një spostim masiv të parasë nga bastet tek ekonomitë për familjet... Nëse do ishte se nuk e kontrollojmë dot, le të shikojmë si e kanë vende më të forta se ne. Shko vër baste në Nju Jork. Shko tek Trump dhe vër bast. Ne kemi punuar për këtë për disa muaj. Është e vërtetë që e nxorëm menjëherë, por kemi punuar disa muaj me një grup të ngushtë. Nëse do e kishim hapur më parë dhe më shumë do kishin hedhur balatë. Në 1 janar mbyllen të tëra. Mbyllen kazinotë, mbyllen bastet, mbyllet 'online' që është këtu. Po punojmë që të mbyllet dhe 'online' që janë jashtë që të mos kenë akses këtu. Baste tek bordura para hoteli "Dajtit" visheshin në kohën e Enverit. Është njësoj si të krahasosh një flotë të tërë në det me kalamajtë që kapin peshk tek ligeni me kavanoza. Ne po mbysim një flotë të tërë kriminale që shkatërroi këtë qytet.

YLLI NË KOLLARE

Kryeministri Edi Rama u pyet në emision se përse kishte dje një kravatë me yll. "Autori i kravatës të çon për shpifje. Në vendin e autorit të kravatës shkon në burg", ka ironizuar Rama.

A mund të themi se "Fundi i Marrëzisë" ka dështuar dhe qeveria ka dështuar për ta luftuar këtë plagë sociale në 5 vite që keni qenë në pushtet?

Ne jo vetëm që nuk kemi dështuar, por përkundrazi kemi vendosur goxha rregull në një fushë ku ka shumë lull dhe ka shumë informalitet ende. Kemi vendosur goxha rregull. Këto i rrëzon vetëm një fakt. Unë e kontestoj raportin e KLSH-së. Kompanitë që merren me këtë punë janë përgjysmuar dhe të ardhurat që merr shteti janë dyfishuar.

Kompanitë mund të jenë përgjysmuar, por pikat e basteve janë shumëfishuar.

Ka shumë më tepër formalizim se ç'kishte.

Ky vendim u duk sikur erdhi pas vrasjes në Bllok. Kemi bërë një studim të kësaj situatë. Nuk ka lidhje fare me këtë që thua ti. Goditja është bërë bllok.

Unë përmenda emrin e Dakos për shkak të autobuseve të Durrësit me reklamata e basteve.

Autobusët janë linja private dhe nuk pyesin bashkinë se çfarë reklame të



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë intervistës në emisionin "Dritare" të gazetares Rudina Xhunga, në "News 24"

bëjnë. Pra, ti duhet të bësh investigimin pas asaj që ke parë. Mos flisni me hamendje.

Është ofenduese për qytetarin që reklamata të bllokohen autobusët.

Unë jam babai i një djali 4-vjeçar dhe një 30 vjeç. Unë nuk i kam borxh askujt që djali im të rritet në terrorin e shpifjes. Unë jam babai i një djali 4 vjeç... Nuk e harroj atë momentin kur djali im ishte futur poshtë krevatit se kishte dëgjuar se ai nuk ishte djali im. Nuk shpifin gazetaret në botë. Thotë njëri këtu vëllai jot kështu, e del ky tjetri. Këtu nuk diskutohet fare për ngjarjet që u interesojnë njerëzve.

Shqipëria është rënditur si vendet e para për konsum kokainë...

Kjo është një idiotësi. Nuk mund të jetë Shqipëria në vendet e para, sepse kokaina është më e shtrenjta. E para kjo. E dyta, ne kemi futur të gjithë oficerët e shkollave për të ndihmuar prindërit, nxënësit. Ata janë të formuar në shkollën e policisë, por kanë njohuri edhe në aspektin sociologjik. Tjetër është opinioni, keni lirinë të keni një opinion negativ për qeverinë, për të shkuar deri në fyerja. Mund ta merrni guximin t'i thoni kryeministrit palaço. Po i nxini jetën këtyrë milet, por e bombardoni: krimi, krimi, droga. Shqipëria ka pasur, por ju nuk

doni fakte. Ne e hapëm luftën ndaj kanabisit, ju ishit pajtuar. Dilte në TV si vend ekzotik. As s'i hyri gjë në këmbë.

Dhe ju e hapët në të gjithë Shqipërinë...

Kjo është shpifje. Ju jeni të detyruar t'i verifikoni në çdo cep të Shqipërisë. Deri në 2013-ën policia nuk nxirrte komunikata. Ato që kapeshin ishin minimale, në krahasim me atë që prodhoheshin. Parametrat e raportit shtet-ligjit.

Nëse unë do isha e papunë nesër nga bastet, ku do punoja?

Janë rreth 700 mln euro që do spostohen nga kumarhanet në ekonomi dhe të gjitha këto mjedise, këta njerëz që janë të vetëpunësuar do ndryshojë. Ato lokale që u është rritur vlera në mënyrë artificiale për shkak të basteve, do kthehen në treg për aktivitetet të tjera biznesi.

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit, në mbledhjen e grupit parlamentar të 8 tetorit ju keni thënë se e keni çrrënjësuar përfundimisht kanabisin. Ndërkohë në ditët e mëpasme janë kapur 1 ton e gjysmë kanabis në Itali nga Shqipëria. Pjetja ime është, a keni fakte alternative?

Kanabisi është çrrënjësuar nga Shqipëria dhe këtë thotë raportit i Guardia di Finanza, i cili edhe vjet ishte i qartë dhe u prit

STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
-Regjistruar në Regjistrin hipotekor me Nr. 2035, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale me Nr. 2460, Apartament (3+1), Nr. 22, me sipërfaqe 136 m², Seksioni Nr. 1, ndodhur në katin e katërt të Godinës së banimit dhe shërbimit 4-7-8 katëshe plus një kat parkim, Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, regjistruar në pronësi të Shoqërisë "Eurovini" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 52,584 Euro.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 26.10.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:
- "Apartament Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Dajç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 27,880 Euro.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 24.10.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



Rruga Tiranë-Elbasan, "Nëse nuk mbaron deri në fund të vitit, ikën Gjijnuri"

Kryeministri: Ndryshimet në qeveri janë puna ime, i pakënaqur nga vetja

"Nëse do dënohej shpifja, shumica e gazetarëve do ishin në burg"

para është se unë nuk kam asnjë kontradiksion. E fitoj garën me ty nëse do të bëjmë analizën për qeverinë. E kenë bërë fjalën si farë kungulli. Unë jam vetëkritik, unë jam me veten time përballë, por të jesh i sigurt se nuk i them vetes bravo. Nuk heq drejtorët e policisë unë. Ndryshimet në qeveri janë punë e imja.

Je i kënaqur nga bilanci i punës së Fatmir Xhafajt?

Pakënaqësinë më të madhe e kam tek vetja.

Ajo vajza brodhi komisarjat në komisarjat dhe ai djali nuk u ndëshkua, se është djalë deputeti.

O Zot, o Zot, ai djalë është në burg.

Tani, jo më parë. Ka që në dhjetor kjo çështje.

Shpifje, shpifje. Ka një vit që brend komisarjateve dhe është shpifje?

Ju jeni bërë prokurorë, gjykatës, inkuizitorë. S'ka asnjë provë që deputeti ka mbrojtur djalin e vet.

Unë e përmtoj, se është babai i një djali që ka dhunuar një grua.

Ai burri është i zgjedhuri i atij komuniteti për disa mandate rresht. Është një person që e njeh ai komunitet atje. Ai burri që ju flisni, që sot është pranë shtratit të gruas që po vdes, nga spitali nuk është marrë fare me djalin. Ju kujtoni se ne jemi të gjitha derra të kënaqur. Djali i tij është në burg. Ky është stan-



dardi i kësaj qeverie. Kemi pasur deputetë e ministra që i fiknin cigaret në ballë kameriereve.

Nëse ju do kishit bërë këtë që keni bërë, do ishit në burg tani. 25 vende të BE e dënojnë me burg shpifjen. Kroacia e hoqi dhe pas anëtarësimit e vuri prapë. Me këto që bëni ju, do ishit në burg sot. Nuk po them për të gjithë ju, se nuk jeni njësoj. Unë nuk kam parë gazeta dhe portale në Francë e Itali që të bëjnë ironi dhe të hedhin shigjeta me kryeministrin. Por këto që bëni ju është e paimagjueshme. Një shpifës nuk meriton një supë në burg. Gazetarët shpifës dhe shpifësit duhet të tundin le-

kët. Në mars të këtij viti kemi deklaruar o do të mbaroj rruga Tiranë-Elbasan, ose mbaron Damiani.

Deri në fund të këtij viti është e mbaruar. Deri në fund të vitit do të shkosh në krahun tjetër, ose s'do të jetë Damiani.

Ju thoni se keni bërë reforma. Ka disa shifra zyrtare të reformës territoriale, ndër të tjera thotë se do të kurseni para. Në 2015-ën ishin 2.7 miliardë lekë te të gjitha bashkitë, sot janë 5.2 miliardë. Janë rritur shpenzimet për administratën.

Janë rritur, sepse bashkitë kanë një pjesë të grantit në dorë, por ne do të përdorim një limit, sepse fusin njerëz

në punë pa kriter. Unë jam i besuar i një pale. Është turp të akuzosh në shekullin 21, ta bësh fajtor. Taulant Balla akuzohet se ka qenë në komisarjat. Për sa kohë ti nuk e di, Taulant Balla është i pafajshëm.

Akuzohet Taulanti se ka bërë 57 udhëtime me Edmond Begon, nuk doli kush të thotë se doli Pandeliu. Ne thoshin se Elvis Roshi ishte i dënuar, ti thoshe se nuk është.

Nuk bëj inkuizicion. Ata që shkojnë e turpërojnë Shqipërinë në Bruksel. Unë jam i besuar i njëjës pale, ju jeni i palës publike. Ju keni marrë fund, sepse bëni garë për të marrë në intervistë "Babalen". Kasetat është një montazh.

me entuziazëm nga komuniteti ndërkom-bëtar. Këtë vit është rrafshuar komplet. Ndërkohë që ka tek-tuk. Janë stoqe të së kaluarës. Nga kapjet që janë bërë andej është më shumë se 1/10 e asaj që transportohej vetëm nga Lazarati dhe janë stoqe të së kaluarës.

Është droga e Saimirit që ka ngel?
Ç'të të them unë ty. Kjo është fjali e njeriut që sikur ka humbur një bast.

Xhunga: Unë kam dëgjuar sa drogë u mboll me Berishën me Ramën...
Nga duart e krimi janë hequr 180 mln euro.

Ambasadori amerikan tha se janë 20 familje mafioze. Mund të na thoni një emër?
Jeni shumë qesharakë.

Krimi te Blloku....

Ore s'të dhashë përgjigje për kriminelët. Sot 140 persona të skeduar janë në burg. Ne jemi vonuar për kapjen e Bajrave, sepse 6 muaj ishim duke pritur nga Belgjika atë copë letër, e cila na jepte mundësi veprimi. Kam dëgjuar shumë emra, i ke brenda.

Ju pashë para policëve dje, një kryeministër evropian del e mban fjalën para policëve, kjo nuk ndodh në vendet e tjera. Del iu thua se s'keni kapur Ballin. Jeni kryeministri që keni një mandat të fortë, ju duket sikur i keni duart e lidhura.

Mi ka lidhur krimi (qesh me ironi). Mos u shqetëso për energjitë e mia, sepse kam mjaftueshëm. Jam i vendosur që një pjesë të energjisë ta përdor kundër shpifjes. E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,996,800 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Nentor 2018, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një makine numëruese dhe paketuuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,060,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një makine numëruese dhe paketuuese për monedhat metalike, si dhe shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 08 Nentor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

SHKODËR - Gjykata e Apelit në Shkodër ka lënë dje në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg" për ish-drejtorin e Hipotekës në Shkodër, Zamir Leka, i cili akuzohet për korrupsion. Ndërkohë, për ish-juristen Frida Mirashi është caktuar masa e sigurisë "arrest shtëpie". Gjatë seancës gjyqësore, ish-drejtori i Hipotekës, Zamir Leka ka kërkuar lirimin e tij për shkak të rrethanave familjare. Gruaja e tij është shtatzënë, ndaj është kërkuar një masë



Zamir Leka: Më lironi, kam gruan shtatzënë!

Merrte 5 mijë euro ryshfet për regjistrimin e pasurive, Apeli lë në burg ish-kreun e Hipotekës

më e butë. Ndërkaq, Leka ka qenë i gatshëm që të vendosë edhe garanci pasurore. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga trupi gjyqësor, i cili ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, duke lënë në qeli ish-kreun e Hipotekës.

Ai u arrestua më 25 shtator të këtij viti teksa ndodhej në zyrë (10 minuta para përfundimit të orarit zyrtar të punës. Mbi Lekën dhe Mirashin rëndojnë akuzat e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës gjatë kohës që kanë qenë në detyrë.

Sipas prokurorisë, ai merret para për regjistrimin e pasurive dhe lejet e legalizimeve. Hetimet kanë nisur që më 30 gusht. Pas vënies në pranga, prokuroria bëri me dije se ka zbuluar se si i kryente skemat e korrupsionit drejtori i Hipotekës.

"Bëhet fjalë për praktikë të caktuara, për të cilat më parë është marrë vesh për pagimin e shumave të kundërligjshme, deri në 5000 euro apo i mban në pritje të ofertave nga të interesuarit. Në momentin që merr përfitim e kërkuar, i kalon praktikat përkatëse tek juristët e zonave, në disa raste vetë dorazi, në disa raste të tjera nëpërmjet juristes Frida Mirashi", thuhet në njoftimin e organit të akuzës.

Nëna e njërit prej viktimave: Djalin ma morën, i vunë pistoletën në kokë

SHKURT

20 mijë lekë për të kaluar në provim, arrestohet infermierë

KORÇË - Alku Gjalli, me profesion infermier pranë të spitalit të Korçës ka përfunduar dje në pranga, pasi akuzohet se iu merrte para studentëve për të kaluar në provimet e infermierisë. Burime nga blutë e qytetit juglindor bënë me dije se ndali i 31-vjeçarit nga fshati Vinçan u ndalua, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendim numër 339, datë 16.10.2018, ka vendosur ndaj tij masën e sigurisë "Arrest me burg". Po të njëjtat burime pohuan se Alku Gjalli dyshohet se ka konsumuar elementë të veprës penale "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike". Nga hetimet e kryera në lidhje me këtë rast rezultoi se 31-vjeçari, kundrejt shumave nga 15.000 deri në 20.000 lekë iu premtonte studentëve se do i kalonte në provimet e Fakultetit të Infermierisë-Korçë, në lëndë të ndryshme. Ndërkohë, vijon puna për dokumentimin e plotë të rastit. Materialet hetimore për ndjekje të mëtejshme i kaluan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë.

U kapën për abuzime, Apeli liron mjekët dhe infermierët

SHKODËR - Ditën e djeshme, Gjykata e Apelit në Shkodër ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë për mjekët dhe infermierët e spitalit rajonal të këtij qyteti. Në fund të seancës, trupi gjyqësor ka vendosur "Detyrim paraqitje" për ish-drejtorin e spitalit Përparim Çela, ish-drejtorin dhe mjekun Dhurata Uruçi, infermierin Renato Kepi, ndërsa mjeku Luan Dragusha është totalisht i lirë, pasi ndaj tij nuk ka asnjë masë sigurie në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Po ashtu janë lënë të lira edhe katër punonjëset e administratës. I vetmi që vazhdon të jetë në kërkim është mjeku Edi Smajllaj. Mjekët u akuzuan fillimisht nga prokuroria për disa abuzime lidhur me stendat tek koronarografia.

Tragjedia e Butrintit me 5 të vdekur, arrestohet pas 10 vitesh trafikanti

Albert Gega është dënua me 10 vite burg

Ervis Kuçi
FIER

Një prej organizatorëve të tragjedisë së Butrintit është arrestuar pas 10 vitesh nga policia e Fierit. Bëhet fjalë për 36-vjeçarin Albert Gega nga fshati Kurjan, i cili është dënua me 10 vite burg nga Gjykata e Sarandës për dhënie ndihme për kalimin e paligjshëm të kufirit. Mësohet se Gega u prangos nga shërbimet e Seksionit për Trafikun e Paligjshme në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale Fier. Ngjarja për të cilën është dënua ai ka ndodhur në tetor të vitit 2008 në liqenin e Butrintit. Albert Gega në bashkëpunim me pesë shtetas të tjerë kanë ndihmuar për të kaluar në mënyrë të paligjshme 22 persona, 5 prej të cilëve u mbytën në liqen. Në mes personave që tentuan kalimin e kufirit një dekadë më parë ishte edhe 20-vjeçari Festim Hoxha, i cili humbi jetën. Pas lajmit për kapjen së njërit prej trafikantëve, "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me prindërit e Festimit. Babai, Kadri Hoxha u shpreh se "im bir ishte në KEMP. E kishin marrë për ta ndihmuar, për ta çuar te motra në Greqi. Nuk ishim ne ata që e nisëm". Gjithashtu, 78-vjeçari tha përmes lotëve se Festimin e kishte djalë të vetëm dhe se gjithë jetën për të kishte punuar. Të njëjtën gjë pohoi edhe nëna e viktimës, Liria: "Djalin e kanë marrë me zor. Kur na mori në telefon përpara se të mbytej, tha se nuk kthehej dot pas. Kishte pistoletën në kokë. E parandieja që do ndodhte diçka e prandaj i thashë të mos ikte".



Arrestuari Albert Gega



Tragjedia e Butrintit

TRAGJEDIA NË BUTRINT

Tragjedia e Butrintit shkaktoi 5 viktima, mes tyre edhe foshnja 3 muajshe, Klara. Sipas prokurorëve, viktimat ishin mashtruar nga sekserët e trafikut të qenieve njerëzore kundrejt përfitim të një shpërblymi të majmë, që shkonte deri në 1200 euro. Liqeni i Butrintit kalohet me varkat e peshkimit me ngarkesë sa dyfishi i kapacitetit të tyre, duke rrezikuar ekstremisht jetën e

BABAI I VIKTIMËS
Në mes personave që tentuan kalimin e kufirit një dekadë më parë ishte edhe 20-vjeçari Festim Hoxha, i cili u mbyt në liqen. Babai, Kadri Hoxha u shpreh se "im bir ishte në KEMP. E kishin marrë për ta ndihmuar, për ta çuar te motra në Greqi. Nuk ishim ne ata që e nisëm".

njerëzve. Varka prej druri që shkaktoi tragjedinë kishte nisur udhëtimin e vdekjes me 22 persona, të cilët sapo kishin përshkuar afro një kilo-

metër sipërfaqe ujore, u përmbyt tek prita e peshkimit në Vivar. Trafikantët ishin përpjekur t'i shmangeshin Policisë Kufitare, duke shkakto-



20-vjeçari Festim Hoxha, i mbytur në tragjedinë e Butrintit

VIKTIMAT E TRAGJEDISË

1. Elvira Jaho, 22 vjeçe nga Lapardhaja e Beratit.
2. Klara Jaho, 3 muajshe, e bija.
3. Festim Hoxha, 20 vjeç nga Vidhishti i Fierit.
4. Amarildo Kuka, 25 vjeç nga Kumani i Fierit.
5. Ndrim Myftari, nga Imshti i Lushnjës.

PERSONAT E DËNUAR

1. Hyqmet Sollaku, 21 vjet burg dhe 8 mln lekë gjobë.
2. Brahim Madhi, 16 vjet burg dhe 8 mln lekë gjobë.
3. Dashmir Mane, 17 vjet burg dhe 8 mln lekë gjobë
4. Albert Gega, 10 vjet burg dhe 6 mln lekë gjobë.

ar kështu një tragjedi të rëndë me vdekjen e 5 personave që ishin nisur drejt Greqisë. Nga hetimet e nisura menjëherë pas ngjarjes, Prokuroria e

Sarandës dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda zbuluan autorët e rrjetit të trafikut me shtrirje të gjerë si nga Fieri, Berati dhe Tirana.

Sot do të dëshmojë ish-drejtori i Policisë Bashkiake, Florenc Hoxha

"Babalja", kreu i policisë pyetet për një orë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda

Ardi Veliu: Nuk e kam shoqëruar Alizotin me makinë, atë ditë kam qenë në një aktivitet

TIRANË

Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, dje ka dëshmuar për afro 60 minuta në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, në lidhje me videon e kumatit të "Babales". Pas dëshmisë në video të Fredi Alizotit, se ai ishte çuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda me makinë nga kreu i Policisë së Shtetit, Veliu, ky i fundit u mor dje në pyetje. Ai u paraqit te Krimet e Rënda në orën 13:00, ku dha sqarime për çështjen "Babalja". Burime pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda bënë me dije se Ardi Veliu ka mohuar akuzat e Alizotit. Sipas drejtorit të policisë, në atë datë që pretendon Alizoti se e kishte shoqëruar me makinë, ai kishte qenë në një aktivitet. "Zoti Veliu ka mohuar që të këtë bërë një shoqërim të Fredi Alizotit. Ai tha se në datën që Alizoti pretendon se është shoqëruar nga ai me makinë, ka qenë në një aktivitet", thanë burimet nga organi i akuzës. Gjatë seancës së pyetjeve i ka qëndruar versionit të dhënë më herët nga Policia e Shtetit se Fredi Alizoti në Tiranë ishte sjellë nga zyrtarë të Policisë së Fierit. Ardi Veliu ka mohuar të ketë shantazhuar apo joshur Fredi Alizotin për të ndryshuar qëndrimin dhe të dëshmonte se e kishte bërë ai rolin e Agron Xhafajt në audiopërgjimin e parë. Pas publikimit të videos në fjalë, Policia e Shtetit mohoi se Ardi Veliu ka kontaktuar apo është shoqëruar me personin në fjalë, duke e quajtur videon fund e krye të pavërtetë. Për më tepër, policia tha se mund të verifikohet lehtë se drejtori i përgjithshëm në ditën që shtetasi Alizoti u shoqërua në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ka qenë me an-

PRETENDIMI

Në videon e dytë, Fredi Alizoti pretendon se është marrë në makinë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe i është bërë presion për të dhënë në prokurori dëshmi të rremë lidhur me çështjen "Babale". Gjithashtu, ai pretendon se është takuar edhe nga kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili i ka premtuar para për të ndryshuar versionin e ngjarjes.



Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu

gazhime të tjera. Në dalje nga Krimet e Rënda, drejtori i policisë nuk ka bërë asnjë deklaratë për mediat. Ndërkohë, ditën e sotme do të merret në pyetje nga Prokuroria e Krimeve të Rënda edhe Florenc Hoxha (ish-drejtori i Policisë Bashkiake të Tiranës në kohën e Bashës). Në videon e dytë, Fredi Alizoti pretendon se është marrë në makinë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe i është bërë presion për të dhënë në prokurori dëshmi të rremë lidhur me çështjen "Babale". Gjithashtu, ai pretendon se është takuar edhe nga kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili i ka premtu-

ar para për të ndryshuar versionin e ngjarjes. Fredi Alizoti në biseda telefonike me "Babalën", por edhe persona të tjerë si Florenc Hoxha dhe Erzen Breçanin, ish-policë në kohën e PD-së, pohan se zërin e Agron Xhafajt, vëllait të ministrit të Brendshëm e ka bërë ai, si dhe për vënien në jetë të këtij skenari do paguheshin 200 mijë euro nga deputeti me mbiemër Saliqin. Gjithashtu, bazuar gjithmonë të përgjimit e zbardhura, Alizoti shprehet i zhgënjyer me Albert Velin, i cili nuk i ka dhënë asnjë lek dhe ishte larguar në drejtim të Kosovës për azil. Grupi hetimor i dosjes "Babale" do të pyesë të gjithë personat që për-

menden nga Fredi Alizoti në videon e bërë publike. Burimet konfirmojnë se në prokurori do të thirret edhe

kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla. Kjo për faktin se Fredi Alizoti në video pretendon se ditën kur

është marrë në pyetje në prokurori, ka qenë i pranishëm në ambientet e jashtëme edhe deputeti socialist.

DOSJA "BABALE"

Grupi hetimor i dosjes "Babale" do të pyesë të gjithë personat që përmenden nga Fredi Alizoti në videon e bërë publike. Burimet konfirmojnë se në prokurori do të thirret edhe kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla. Kjo për faktin se Fredi Alizoti në video pretendon se ditën kur është marrë në pyetje në prokurori, ka qenë i pranishëm në ambientet e jashtëme edhe deputeti socialist.

Prokurori Adnan Xholi kalon vetingun, rikonfirmohet në detyrë

TIRANË - Prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme, Adnan Xholi është rikonfirmuar në detyrë, duke kaluar kështu vetingun. Vendimi në fjalë u dha dje nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. "Subjekti i rivlerësimit me veprimet apo rivlerësimet e tij nuk ka cenuar interesin e publikut dhe ka arritur veprime të besueshme. Trupi gjykuës e konsideron seancën të përfunduar. Prokurori rikonfirmohet në detyrë", tha drejtuesja e seancës së KPK-së. Sipas ILDKP, Adnan Xholi ka bërë deklarin të saktë të pasurisë dhe nuk ka fshehje. "Prokurori ka kursime të tij



Prokurori Adnan Xholi, dje në KPK

dhe të gruas rreth 2 mln e 500 mijë lekë. Ka makinë 'Benz' me vlerë 4 mijë euro dhe apartament 107 m², me vlerë 50 mijë euro", - thuhej në konstatimin e KPK, duke iu referuar ILDKPI. Të njëjtin konstatim pati edhe DSJK,

duke u shprehur se prokurori Xholi është i përshtatshëm për vijimin e detyrës. Aktualisht Adnan Xholi është drejtor i Inspeksionit, Burimeve Njerëzore dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve në Prokurorinë e Përgjithshme.

NJOFTIM

Shoqëria "GPP Korça" sh.p.k, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORÇA 500 MW/ 80 MW/ 6 MW në zonën pranë qytetit të Korçës, saktësisht përballë Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Qytetit të Korçës. GPP Korça ka kontraktuar kompaninë ABKONS sh.p.k. për realizimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, si shoqëri e licensuar për veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis.

Për këtë qëllim, Ju njoftojmë se në Korçë do të mbahet një Dëgjese Publike për të bërë publike rezultatet e vlerësimit mjedisor dhe për të diskutuar dhe mbledhur komentet dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit.

Dëgjesa Publike do të mbahet në datën **26 Tetor 2018** në orën **12:00** ne sallën e takimeve tek "Grand Hotel Korça"

Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit dhe Sportit

DAAD
Deutscher Akademischer Austausch Dienst
German Academic Exchange Service

Aplikimi për bursa 2019-2020

Shërbimi i Shkëmbimit Akademik Gjerman DAAD ofron edhe këtë vit bursa për qëndrimin afatgjatë dhe afatshkurtra studimi në Gjermani. Për këto bursa mund të aplikojnë studentët, absolventët si dhe shkencëtarët të të gjitha fushave:

- Bursa për kërkime shkencore për akademikë, për doktorantë, shkencëtarë të rinj, si edhe ish-bursantë të DAAD-së
- Bursa studimi për absolventë të të gjitha fushave (master)
- Bursa studimi për artistë
- Bursa për frekuencim të kurseve verore për studentët nga të gjitha degët që kanë njohuri në gjermanisht

Afati i fundit i dorëzimit të aplikimit është:

- 15.11.2018 pranë Ambasadës Gjermane për të gjitha degët e tjera
- 30.11.2018 direkt në zyrën e DAAD-së në Bonn për degën Film, Design, Fine Arts
- 01.12.2018 pranë Ambasadës Gjermane për kursimet verore

Informacione për ofertat e mësipërme, kushtet e aplikimit, procedurat dhe formularët mund t'i merrni në faqet e mëposhtme:

www.daad.de DAAD Lektorat Albania

Dr. Jeanette Rieger-Cowdry
rieger-cowdry@daad-al.org
(Lektore e DAAD-së në Tiranë,
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, kati II
Universiteti i Tiranës)

Alba Cani
cani@daad-al.org
(Asistente e lektoratit të DAAD-së në Tiranë,
Fakulteti i Ekonomisë, kati I,
Universiteti i Tiranës)

Fotografi e stampa me fytyrën e tij, kush ishin pjesëmarrësit

Ditëlindja e 110 e Enver Hoxhës, Iliiri "rrethohet" në varreza

Shfaqet Lenka Çuko, për vizitë në shtëpinë e Nexhmjes

Edhe pse kanë kaluar 27 vjet nga rënia e bustit të Enver Hoxhës, në 110-vjetorin e lindjes së tij, simpatizantë të ardhur nga Kosova e Maqedonia kanë bërë homazhe në varrezat e Sharrës. Iliir Hoxha djali i madh i Enverit bashkë me Besmirin, të birin, kanë qenë në varrin e Enver Hoxhës në shenjë përkujtimi të ditës që deri në vitet '90 njihje si Dita e Enverit. I befazuar nga simpatizantët e shumtë, që kishin mbërritur në varreza në shenjë respekti për komandantin legjendar siç shprehen ato, Iliiri i falënderoi nga ana e familjes dhe i shprehu mirënjohjen e thellë. Më duartrokite, stampa me fytyrën e Enver Hoxhës mbi xhakët, portrete të tij nëpër duar e buqeta lulesh të ardhurit më specialë në homazhet mbi varrin e Enverit ishin një



grup nga Zvicra. Sigurisht aktivë në këtë ditë mbeten Muho Asllani e Muharrem Xhafa, të cilët nuk lënë ditëlindje e përkujtim vdekje pa shkruar në varrin e Enver Hoxhës. Nex-

hmije Hoxha e kishte të pamundur të shkonte në varreza pasi vizitorët e shumtë shkuan në shtëpinë e saj. Sapo ka mbushur të 80-tat vizitorja që duket herët në shtëpinë e Nex-

hmije Hoxhës është Lenka Çuko. Edhe pse mbi të rëndojnë disa vite burg në vitet e pluralizmit, mbahet mirë. Ndërkaq aktivistë të shumtë kanë përkujtuar në Ferizaj



CEREMONIA
Djali i diktatorit, Iliir Hoxha ishte në ceremoninë e organizuar në varrezat e Sharrës, ndërsa e veja e diktatorit, Nexhmije Hoxha priti miqtë në shtëpi. Madje, kjo është fotoja e fundit e shkrepur vetëm dje, ndërsa Nexhmije Hoxha priste vizitorët e shumtë.

110- vjetorin e lindjes së Enver Hoxhës dhe Partia e Punës së Shqipërisë ka pasur aktivitete në këtë ditë. Ndërkaq Teuta Hoxha, nusja e djalit të madh të Enverit,

që në mëngjes shkruan kështu në "Facebook": "Sot për familjen tonë është një ditë e shënuar, në përkujtim të 110-vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



SKEMA E PENSIONEVE NDRYSHIMET

Gati ndryshimi i skemës së pensioneve, rastet e përlllogaritjes

Të vetëpunësuarit në bujqësi do të paguajnë më shumë sigurime

Draftpropozimi: Të shkojë 23% e pagës minimale

Të vetëpunësuarit në bujqësi do të paguajnë më shumë kontribute vullnetare. Ministria e Financave është duke hartuar një draft për ndryshimin e skemës së pensioneve që lidhet pikërisht me pensionet e fshatit. Aktualisht të vetëpunësuarit në bujqësi në zonat fushore paguajnë 38.400 lekë në vit ndërsa për zonat malore 29.400 lekë, çka sipas ministrisë paraqet diferencë të ndjeshme me të vetëpunësuarit në qytet, të cilët paguajnë 66.240 lekë në vit. Deri më tani diferenca është paguar nga buxheti i shtetit, por për të shmangur, atë që dikasteri i financave e quan diskriminimin midis të vetëpunësuarve, propozohet që të vetëpunësuarit në bujqësi kanë detyrimin të paguajnë kontributet e llogaritura mbi një pagë minimale për ta, që mbetet për t'u përcaktuar me vendim qeverie. Kjo do të thotë se masa e kontributit të sigurimeve shoqërore që do të paguhet do të jetë sa 23% e kësaj page. Për shembull, nëse paga minimale për të vetëpunësuarit në fshat do të përcaktohet në masën 20 mijë lekë, atëherë masa e kontributit do të shkojë në 55.200 lekë në vit. Gjithashtu, në rast se të vetëpunësuarit në bujqësi do të duan të kontribuojnë më tepër, me qëllim për të përfituar një pension më të lartë, atëherë do të kenë mundësinë që mund të paguajnë edhe mbi nivelin e pagës minimale në bujqësi do të duan të kontribuojnë më tepër, me qëllim për të përfituar një pension më të lartë, atëherë do të kenë mundësinë që mund të paguajnë edhe mbi nivelin e pagës minimale.



Foto ilustruese

SHEMBULL

Nëse paga minimale për të vetëpunësuarit në fshat do të përcaktohet në masën 20 mijë lekë, atëherë masa e kontributit do të shkojë në 55.200 lekë në vit. Gjithashtu, në rast se të vetëpunësuarit në bujqësi do të duan të kontribuojnë më tepër, me qëllim për të përfituar një pension më të lartë, atëherë do të kenë mundësinë që mund të paguajnë edhe mbi nivelin e pagës minimale.

paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh. "Ndërkohë, i/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh. Pagesat e kontributëve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj", thekson ISSH. Sakaq, afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen si periudha sigurimi. Ndërkohë të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë, për të përfituar pension të pjesshëm, mund të kryejnë pagesa kontributësh pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe të mos jetë caktuar ende asnjë lloj pensioni dhe për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit. ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

PERFITIMET

ISSH bën me dije se të gjithë ata fermerë që ushtrojnë aktivitetin e tyre bujqësor apo blegtoral në fshat, mund të kenë një sërë përfitimesh në sigurohen në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

vizita mjekësore pa pagesë si dhe kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh. "Të nderuar fermerë! Sigurimi në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ju që ushtrojnë aktivitetin bujqësor dhe blegtoral, është investimi më i mirë që mund të bëni për veten dhe familjarët tuaj. Nga ky sigurim ju përfitoni: Pension pleqërie; Pension invaliditeti; Pension familjar për fëmijët tuaj; Sigurim për barrë lindjen për nënat e reja; Vizitën mjekësore pa pagesë dhe kompensimin e çmimit të barnave mjekësore në rast sëmundjeje. Mos humbisni kohë, mendoni për të ardhmen tuaj!", thekson ISSH në faqen e saj zyrtare.

KUSHTET E PËRFITIMIT

Bazuar në ligjin "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u sig-

uruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë disa kushte. Kështu individit duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç; të jetë i/e aftë për punë; dhe të mos jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Gjithashtu, i vetëpunësuarit në bujqësi duhet të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale. Por ai edhe mund të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë. Vlen të theksohet se ka të drejtë të sigurohet çdo person deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension.

PAGESA E KONTRIBUTEVE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm dhe ky i/e vetëpunësuarit/a, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim,

KUSHTET PËR T'U SIGURUAR

Personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të ketë mbushur moshën 16 vjeç;
2. Të jetë i/e aftë për punë;
3. Çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension;
4. Nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;
5. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi duhet:
 - Të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale;
 - Të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë.

Pagesat e kontributeve

1. Sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm.
2. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.
3. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.
4. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj.
5. Afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Raporti i qendrës 'Vatra'/ Rritet rekrutimi nga rrjetet sociale. 68% e tyre, nën 18 vjeç

Trafikimi, viti 2017 thyen rekordin, 59% e viktimave janë shfrytëzuar seksualisht

Shumica e vajzave dhe grave mashtrohen me premtime për martesë

Voltiza Duro

N umri i viktimave të trafikimit gjatë 2017-ës ka pësuar një rritje krahasuar me 2016, përkatësisht me 44 raste të reja, e kjo vetëm një prej qendrave psiko-sociale në Vlorë. Aktualisht në qendrën 'Vatra' trajtohen 123 viktima apo viktimat të mundshme të trafikimit, nga të cilët 76 raste janë adulte, ndërsa 37 raste janë fëmijët e viktimave. Sakaq 42 viktima përfituese të programit të rehabilitimit dhe 28 fëmijë të tyre janë të mbartura nga viti 2016, të cilat kanë qenë përgjatë tri fazave të programit.

LLOJET E SHFRYTËZIMIT

Nga 44 raste të asistuar, 89% (39 raste) e tyre janë shfrytëzuar brenda vendit, në Shqipëri, (kryesisht në qytete si: Tirana, Vlora, Elbasani, Durrësi, Berati, Shkodra, etj.); 2% e tyre janë shfrytëzuar jashtë vendit (në vende të tilla si: Itali, Greqi, Gjermani, Maqedoni) dhe 9% janë shfrytëzuar brenda dhe jashtë vendit. Kryesisht viktimit kanë qenë objekt i shfrytëzimit seksual, shfrytëzimit për lypje, punë të detyruar, kryerjen e veprave penale (vjedhje, shpërndarje droge etj.), dhe i më shumë se një lloj shfrytëzimi. Konkretisht, 59% e rasteve janë përdorur për shfrytëzim seksual, 21% janë shfrytëzuar për lypje; 3% për kryerjen e veprave penale (vjedhje, shpërndarje droge). Në 17% të rasteve viktimit kanë vuajtur më tepër se një lloj shfrytëzimi. "Gjatë viteve të fundit, rekrutimi nëpërmjet rrjeteve sociale, veçanërisht i vajzave të mitura, është rritur ndjeshëm në 11% të rasteve (13 - 18 vjeç). Megjithatë, shumica e vajzave dhe grave janë rekrutuar nëpërmjet premtimeve false për martesë/martesës (20%); të dashurit / bashkëjetuesit / bashkëshortit (18%); premtimeve false për punë (4%), premtimeve për ushqim dhe mbrojtje (25%); shfrytëzimit të situatës vulnerabël (raste me probleme të shëndetit mendor e fizik)14% e tyre", - nënvizohet në studim.



REKRUTIMI I VAJZAVE

Shumica e vajzave dhe grave janë rekrutuar nëpërmjet premtimeve false për martesë/ (20%); të dashurit / bashkëjetuesit / bashkëshortit (18%); premtimeve false për punë (4%), premtimeve për ushqim dhe mbrojtje (25%); shfrytëzimit të situatës vulnerabël (raste me probleme të shëndetit mendor e fizik)14% e tyre", - nënvizohet në studim.


dy vitet e fundit, është rritur numri i djemve viktimat apo viktimat të mbetura në tentativë të trafikimit, kjo edhe falë identifikimit dhe punës së Skuadrave të Terrenit në Vlorë dhe njësitë administrative të saj. Kjo ndikon drejtpërsëdrejti në të gjitha variablat që janë analizuar edhe në vijim. Përqindjen më të madhe të rasteve e zë grupmosha nën 14 vjeç (36.2%); 31,8% grup mosha 14- 18 vjeç; 16% grup mosha 19- 25 vjeç; 7% grupmosha 26-30 vjeç dhe 9% grupmosha mbi 30 vjeç. "34% e rasteve të asistuar gjatë vitit 2017 vijnë nga zonat rurale dhe 66% e tyre nga zonat urbane. Rastet vijnë nga rrethet të ndryshme të Shqipërisë, kryesisht nga Be-

rati, Tirana, Vlora, Elbasani, Shkodra etj. Duhet përmendur se krahasuar me dy vitet e fundit, është rritur numri i rasteve VeT/VmT nga qyteti i Vlorës falë identifikimit dhe punës së Skuadrave të Terrenit në Vlorë dhe njësitë administrative të saj. Ashtu siç edhe përkruhet në grafikun përkatës, 78% e rasteve të asistuar janë beqare, 11% të divorcuara dhe 11% e tyre janë të martuara, disa prej të cilave janë asistuar nga avokatja e qendrës për zgjidhjen e martesës ose kanë shkëputur marrëdhëniet nga bashkëshorti prej kohësh", thuhet në studim. Në raport theksohet se rreth 42% e rasteve që trajtohen në qendër

VIKTIMAT

Nga 44 raste të asistuar për herë të parë gjatë vitit, 73% janë vajza dhe gra dhe 27% janë djem, kryesisht minoronë. Krahasuar me dy vitet e fundit, është rritur numri i djemve viktimat apo viktimat të mbetura në tentativë të trafikimit, kjo edhe falë identifikimit dhe punës së Skuadrave të Terrenit në Vlorë dhe njësitë administrative të saj.

eve nëpërmjet programeve të informimit, edukimit, advokimit dhe shërbimeve sociale rezidenciale dhe komunitare". 'Vatra' ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh dhe shërbimesh, të cilat kanë kontribuar në: ndërgjegjësimin e opinionit publik për rrezikun që paraqesin fenomenet e trafikimit njerëzor, dhunës në familje dhe problemet e tjera që ato gjenerojnë; përmirësimin e statusit social të një numri të konsiderueshëm viktimash të trafikimit dhe dhunës në familje; fuqizimin e kapaciteteve të punonjësve të strukturave shtetërore dhe OJF-ve lidhur me identifikimin dhe ndihmën për viktimit e trafikimit njerëzor dhe dhunës. Përfitueset e akomoduar në strehëz kanë marrë shërbimet bazë, si ushqim, veshje, shërbime të higjienës, shërbime shëndetësore, psikologjike, ligjore, arsimore, socio- edukative, argëtuese, ndërmjetësim me familjen, ndërmjetësim për formim profesional, ndërmjetësim për punësim, mbështetjen me dokumente identifikimi. Të gjitha këto shërbime janë realizuar në bashkëpunim me institucione publike dhe jo publike, si dhe me një shkallë të lartë sigurie; siguri 24 orë e ofruar nga shërbimi policor privat, shoqërim me punonjëse sociale dhe staf tjetër profesional. Në apartamente gjysmë të pavarura (apartamente me qira të mbështetur nga programi) apartamentet me qira, të paguara nga programi i Vatrës, ofrohen për rastet vet/vmt nga 6-12 muaj (në varësi të nevojave). Nga ky shërbim kanë përfituar 7 përfitues dhe 7 fëmijët e tyre në fazën e dytë të programit. Duhet theksuar se rastet kanë marrë fillimisht shërbime në strehëz në fazën e parë të programit dhe më pas, vlerësuar nga grupi multidisiplinar, kanë kaluar në fazën e jetesës gjysmë të pavarur. Dy përfitues dhe katër fëmijët e tyre, që u mbështetën me apartamente me qira nga programi i Vatrës, gjatë 2017, u përfshinë në skemën e banesave sociale në Bashkinë Vlorë.



janë duke frekuentuar shkollën, 12% janë me arsim 8 vjeçar, 11% janë me arsim 9 vjeçar, 7% e tyre kanë arsimin e mesëm, 2% e tyre janë në moshë parashkollë. Ndërkohë 21% kanë braktisur shkollën, dhe madje 5% e tyre nuk e kanë frekuentuar asnjëherë shkollën. Pas ofrimit të shërbimeve nga qendra, 4 raste (11%) kanë rifilluar shkollën.


IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE

Identifikimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, është realizuar duke u bazuar në PSV. Kështu gjatë 2017, janë referuar për shërbime

tek 'Vatra' për herë të parë 44 viktima/viktima të mundshme të trafikimit, të cilat janë identifikuar dhe është njoftuar AP. Policia mbetet referuesi kryesor për shërbime (41% e rasteve); Skuadra e terrenit (36% e rasteve) dhe 23% e rasteve janë referuar nga QKPVT dhe ofruet lokale dhe kombëtarë shërbimesh.


TRAJTIMI REHABILITUES

Në kuadër të misionit të saj, "parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në shoqëri, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të viktimave të këtyre fenomen-



GJINIA DHE MOSHA E VIKTIMAVE

Nga 44 raste të asistuar për herë të parë gjatë vitit, 73% janë vajza dhe gra dhe 27% janë djem, kryesisht minoronë. Krahasuar me





Zv.rektorja Anni Dasho Sharko: Së shpejti vijmë me akademinë Cisco dhe Mikrosft

Universiteti "Luaraasi", bashkëpunim me akademinë Mikrotik për teknologjinë Studentët, më afër tregut të punës e bizneseve

Voltiza Duro

Universiteti "Luaraasi" vazhdon të surprizojë me risi dhe bashkëpunime të fuqishme me kompanitë më prestigjioze në tregun e punës. Në Fakultetin më të ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, studentët e vitit të parë në nivelin Bachelor janë njohur me akademinë Mikrotik. Kjo akademi do të ofrojë kombinimin e teorisë me praktikën si dhe qasjen e studentëve me bizneset që operojnë në fushën e teknologjisë. Dritan Vresha, administrator në një prej kompanive në fushën e networkit dhe internetit, iu ka shpjeguar të rinjve mundësitë e arta që do tu ofrohen nëpërmjet këtij bashkëpunimi që është drejt finalizimit. "Janë bërë disa përpjekje, të cilat do të rezultojnë të suksesshme shumë shpejt. Ky bashkëpunim konsiston në ngritjen e Mikrotik akademii, e cila është një kompani që krijon routera, pajisje që përdoren për network, e përdorur nga shumë vende të botës. Luaraasi do të jetë universiteti që do të prodhojë kuadrot shqiptarë për tregun shqiptar dhe të huaj, për të plotësuar nevojat me ekspertë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe inovacionit", -tha Vresha para studentëve të "Luaraasi"-t.

BASHKËPUNIMI

Akademia Mikrotik do t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në universitetin "Luaraasi" që të praktikojnë njohuritë sipas një programi që aplikohet në shumë universitete prestigjioze në mbarë botën. Dritan Vresha thekson se në fund të praktikës, studentët do të pajisen me një certifikatë që do të njihet jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel global. "Bashkëpunimi me universitetin

BASHKËPUNIMI
Akademia Mikrotik do t'u vijë në ndihmë të gjithë studentëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit në Universitetin "Luaraasi" që të praktikojnë njohuritë sipas një programi që aplikohet në shumë universitete prestigjioze në mbarë botën. Dritan Vresha thekson se në fund të praktikës, studentët do të pajisen me një certifikatë që do të njihet jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel global.



ANNI DASHO SHARKO
"Synimi është që të dalin sa më shpejt ekspertët e IT-së, si në fushën networking edhe në atë të programimit. Kjo është një ndër metodat më të mira për të bërë një qasje mes teorisë, biznesit e praktikës. Edhe në ditët në vijim, në Universitetin "Luaraasi" do të ketë shumë të ftuar guest lecture, të cilët janë personalitete dhe ekspertë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit për të krijuar bashkëpunime të frytshme me studentët e këtij fakulteti."

Luaraasi do të realizohet me fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Në bashkëpunim me stafin akademik dhe rektoratin dhe kemi biseduar që me studentët e bachelor-it që kanë në kurrkulen e tyre edhe lëndën e rrjetave dhe të networking, ne të bëjmë bashkëpunime me kompani që ofrojnë teknologji që përdoren aktualisht në tregun e punës. Jemi në hapat e finalizimit të bashkëpunimit që në universitetin "Luaraasi", në pjesën e praktikës mësimore dhe seminar, studentët të kenë mundësi të praktikojnë njohuritë që do të marrin duke u bazuar në programin e Mikrotik Akademii. Në fund të praktikës, studentët do të mund të aplikojnë edhe për një certifikatë që do të njihet

jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë"-tregon Vresha. Ky i fundit shton që studentët e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit do të kenë mundësi që këtë praktikë ta kryejnë në laboratorët e universitetit Luaraasi, por kjo njohuri mund të përdoret edhe në praktikën mësimore pranë kompanive të mëdha të teknologjisë.

AKADEMITË E REJA

Ndërkohë zv/rektorja për kërkimin shkencor në "Luaraasi", Anni Dasho Sharko tregon se synimi kryesor është përgatitja e profesionistëve në tregun e punës, çka do të arrihet nëpërmjet krijimit të akademive Cisco, Microsoft dhe Mikrotik. "Fakulteti i ri i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ka ardhur me një vizion të ri për studentët tanë. Ajo që kemi prioritet janë ak-

ademitë që do të operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit. Akademia e parë është akademia Cisco, e dyta Mikrosft dhe sot (dje) kemi pasur një "Guest Lecture" nga akademia Mikrotik, duke bërë të mundur përshatjen sa më shumë të studentëve tanë me teorinë dhe praktikën, duke bërë të mundur që biznesi të jetë sa më pranë nesh; duke bërë të mundur që studentët tanë të jenë aktivë edhe gjatë 3-veçarit të Bachelor-it", -tha Dasho. Ajo më tej shtoi se synimi është që të dalin sa më shpejt ekspertët e IT-së, si në fushën networking edhe në atë të programimit. Kjo është një ndër metodat më të mira për të bërë një qasje mes teorisë, biznesit e praktikës. Edhe në ditët në vijim, në universitetin "Luaraasi" do të ketë shumë të ftuar guest lecture,

të cilët janë personalitete dhe ekspertë në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për të krijuar bashkëpunime të frytshme me studentët e këtij Fakulteti. Realisht stafi akademik i "Luaraasi" është në bisedime me gjithë tregun e biznesit në vend, për të bërë të mundur bashkëpunime, në mënyrë që në vitin e tretë të nivelit Bachelor; studentët të kryejnë një praktikë reale për t'i specializuar më tej. Situacioni elitari "Luaraasi" vazhdon hap pas hapi me plane të mirëvendësuara për të bërë të mundur përgatitjen maksimale të studentëve. Në një nëntor, Mikrotik do të mbajë të parin simpozium në Shqipëri, e të rinjtë që studiojnë në "Luaraasi" do të shikojnë praktikisht sesi funksionon fusha e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit.



SHPALLJE ANKANDI
Datë 23.10.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përbarimare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzansës Hatixhe Shefqet Burhani:
- "Apartament + Trulli" me sipërfaqe 62 m², nr. pasurie 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 2561 datë 07.10.1994, me adresë: Lajga "15 Shtatori", pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Tëpelë.
- Cmimi fillëstar i ankandit të tretë është në shumën 806 400 (tetëqind e gjashtë mijë e katërqind) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 24.10.2018, Ora 16:30
Shoqëria Përbarimare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të dorëzansës Bajfar Alush Murto:
- "Trulli + Ndërtesë" me sipërfaqe trulli 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurie 987, adresa: Shalës, Sarandë.
Cmimi fillëstar i ankandit të dytë është në shumën 1 008 000 (një milion e tetë mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimare "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Përbarimare "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 09.11.2018 8 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I për shitjen e pasurisë të paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 6/90, volumni 9, faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillëstare në ankan 17.640 (Shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



PAGUAJ GJELBËR ME E-FATURA NGA ALBTELECOM



Regjistrohu shpejt
dhe pa pagesë



Aplikacioni
Profili Im



albtelecom.al



Dyqanet
ALBtelecom



VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 17 Tetor 2016 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Ahmetaj raporton për buxhetin faktik, Braçe rri në celular gjithë kohën
- 'EFHARISTO', Kumbaro falënderon Bushatin në greqisht
- Në drekë pas përplasjes, Pollo: Shkova se s'doja të ofendoja Tajarin
- Prindër për herë të parë, Xhaçka uron çiftin e ushtarakëve të Forcës Tokësore

Shtatzënia i jep nur, Elita Rudi shfaqet më e bukur se kurrë



E pranon më në fund! Fjolla Morina tregon ndërhyrjen në fytyrë



Rrëfehet vajza e Tanit të 'Topit': Për ne ai ishte idhull dhe çdo gjë që thoshte ishte ligj



Sara Hoxha: Dashuria ime,
"jo me shikim të parë" me Ledionin

*"Kemi pasur një shtatzëni më përpara,
por zemra e bebit pushoi së rrahuri"*

Grëfhet vajza e Tanit të 'Topit': Për ne ai ishte idhull dhe çdo gjë që thoshte ishte ligj

Sara Hoxha

Flet pa dorashka:



Dashuria ime, "jo me shikim të parë" me Ledionin

"Kemi pasur një shtatzëni më përpara, por zemra e bebit pushoi së rrahuri"



16 tetori ishte 50-vjetori i lindjes së një prej ikonave më të mëdha të medias që bëri shumë bujë me inovacionin që sollti në vitet 2000 në Shqipëri. Nëse ai do të ishte gjallë, Tani i Topit, kështu quhet tashmë prej vitesh, shumë gjëra do të kishin ndryshuar e shumë fate njerëzish nuk do të ishin këto që janë tani. Ndërkohë që për herë të parë, duke qenë se ka qenë tepër e rezervuar nga mediat për jetën e saj, ka folur për një intervistë ekskluzive për revistën "Who" të drejtuar nga vetë bashkëshorti i saj, Ledion Liço, një nga vajzat e Dritan Hoxhës, Sara. Në një rrëfim pa dorashka ajo ka folur për shumë të pathëna lidhur me jetën e saj kur i ati ishte gjallë, kujtimet, mësimet e vendimet që ajo mori më vonë pas ndryshimit të jetës së saj. "A ka qenë dashuri me shikim të parë?"- pyet Ledioni bashkëshorten e tij. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



gejfi, merrte kërkesat e telefonuesve për "Një këngë për ty". Nuk e mendoja kurrë që 10 vite më pas ajo do të ishte e dashura ime, pastaj nëna e djalit tim, dhe në gusht të këtij viti do të më thoshte "Po"-në e përjetshme në altar. Si një prej njerëzve më afër saj, mund të mendoj që di shumicën e përgjigjeve, jo të gjitha, sepse disa pyetje nuk ia kam bërë kurrë, dhe sot po marr përsipër, modestisht, të shuaj kuriozitetin e publikut për të, si dikush që është tepër e rezervuar; introverse e që të qenit e famshme nuk e kishte zgjedhur të saj; si dikush që të qenit e tërhequr i vjen natyrshëm në epokën kur të gjithë duan të ndajnë gjithçka me të gjithë. Sara për mua është frymëzim, është një model për brezin e saj, një brez që jetën e ka të varur në përgjithësi nga sipërfaqja dhe show-of-i. Njësoj si kolumnistët me kohë të plotë bëjnë në revistat botërore, vendosa që përgjigjet për "revistaeho.com" t'ia marr në një 'date-night', një nga ato që bëjmë përjavë, ose të paktën mundohemi, sepse familja, miqtë dhe puna shpesh të futen në pjesë. Kjo si një mënyrë për të mos harruar njëri-tjetrin, vetëm ne, në një takim, në një restorant të qetë dhe jo nga ato vanitozët, me një

gotë verë, nga ato takime që na munguan në fillim të lidhjes.
ledioni: Kjo është e çuditshme?
Sara: Po, është...
ledioni: Jo fakti që po dalim për 'date-night'...
Sara: Jo, që ti do të më bësh pyetje dhe unë nuk do të rri në telefon (qesh).
ledioni: Ne nuk kemi dalë dot në takime në fillim...
Sara: Atëherë, ëhë...
ledioni: Në fillim rrinim te shtëpia ime, sepse nuk donim që ta merrte vesh njëri.
Sara: Po, po edhe sepse unë nuk e dija çfarë po bëja me jetën time.
ledioni: Përpara se të vazhdojmë me historinë tonë, e nisim nga mami. Si do e përshkruaje marrëdhënien tënde me Vjollcën; si ka ndryshuar ajo pas humbjes së babit, pastaj fakti që është gjyshja e London, pa harruar që ndan biznesin me të, është "Presidentja e Top Medias"?
Sara: Në fillim unë dhe mami im nuk ishim shumë të lidhura me njëra-tjetrën. Unë isha më tepër vajza e babit, isha më e lidhur me të. Mami ishte tërë kohës aty, e merrja pak për të mirëqenë, ndërsa babit ia ndjeja mungesën, doja ta kënaqja, ta bëja të

ndihet krenar. Pastaj kur babi ndërroi jetë, gjërat morën pak për kot. Nuk është se nuk e doja, se unë vdes për mamin tim, por e bëja atë me faj që babi nuk ishte më. Ishte mbase mënyra ime për t'u përballur me humbjen. Për të do të ketë qenë shumë e vështirë kjo pjesë, por kur e mendoj, isha akoma fëmijë kur ai iku. Pastaj gjërat ndërjuan kur u lidha me ty, sepse më shihte si të rritur, më të pavarur, pra kishim një komunikim të ri dhe më pas kur linda London, arrita të kuptoj vërtet se sa shumë ka bërë ajo për mua, për ne. E shihja vetë se sa e vështirë ishte të rrisje një fëmijë, sa përgjegjës ke dhe i sh- toja dhe faktin që babi nuk ishte aty për të, ajo ishte vetëm, vetëm në familje, vetëm në biznes, por si një Super Grua! Mami im është gjithçka.
ledioni: A të mungonte babi, fakti që nuk ishte me ty tërë kohës?
Sara: Ai nuk ishte nga baballarët që vinte duartrokiste për ty tek shfaqja e shkollës. Po për mua kjo nuk do të thoshte gjë. Ai ishte tërë kohës aty, edhe kur nuk ishte, merrte çdo ditë në telefon, dërgonte mesazhe.
ledioni: A sillej Tani si shok me ju? Apo ishte i rreptë?
Sara: Ishte i rreptë kur duhej. Pra, jo një baba që të bërtet, një baba që të dënon. Për ne ai ishte idhull dhe çdo gjë që thoshte ishte ligj. Nëse bënim

diçka që e mërziste, fakti që e kishim zhgënjyer ishte shumë.
ledioni: Për të shuar një kuriozitet, që unë e kam shuar përpara kohës, por që njerëzit ushqenin legjendat e tyre. Si ka qenë fëmijëria juaj, a flinim në krevate prince-shash, me rubineta floriri?
Sara: Fëmijëria ime, hiq ca udhëtime më tepër që mbase s'i bënim të gjithë, ka qenë e zakonshme. Unë flija me time motër; duke luajtur e duke u zënë deri në kafshime apo shtyrje nga shkallët. Nuk kishim lodra të shtrenjta. Babi nuk donte të na llastonte dhe edhe më vonë, kur dolën telefonat, nuk donte që të kishte njëra prej nesh, diçka që tjetra s'e kishte. Unë

Nga Ledion Liço

5 vite më parë fillova punë në televizionin më prestigjioz në Shqipëri, "Top Channel". Ishte pikërisht aty ku pas- shë për herë të parë Sarën, në recep- sionine "Top Albania Radios", kur nga





Pas dasmës së shumëpërfolur e cila, ashtu si dhe dasmat e tjera ishte private, nuk kemi patur më lajme të reja nga çifti Gjiko dhe Elita Rudi. Kjo e fundit u përfol për një shtatzëni të mundshme duke qenë se edhe fustani i nusërisë, edhe pse pas trupit i jepte asaj një nur dhe tregonte barkun pakëz fryrë e të rrumbullakosur. Edhe pse ajo vazhdon ta fshehtë barkun në postimet e saj, nuk mund të themi të njëjtën gjë për nurin e shtatzënisë. Në një foto selfie të postuar në 'Instagram' ajo duket se ka marrë një nur shumë të bukur dhe mendohet se është shkak shtatzënia e saj. Ndërkohe që në një foto tjetër të dalë në makinë, bukurshja ka mbuluar barkun me çantën e saj. Pra, shumë pikëpyetje dhe mbase vetëm një përgjigje. Por të presim dhe pak muaj, pasi shumë shpejt dyshimet do të bien poshtë. Të jetë vogëlushja/i vallë arsyjeja e nurit të Elitës?

Shtatzënia i jep nur, Elita Rudi shfaqet më e bukur se kurrë



Ajo është një ndër këngëtares, e cila shpesh është vendosur në qendër të vëmendjes për ndërhyrjet e saj estetike. Megjithatë vetë Fjolla Morina i ka mohuar zërat dhe ka treguar se operacioni i vetëm që ka kryer është liposuction (thithje dhjami) në fundshpinë. Ndërsa për sa i përket fytyrës ajo ka kryer asnjë lloj ndërhyrje dhe se nuk dëshironë kurrë ta prekte. Gjithsesi duket se këngëtares i është dashur t'i nënshtrohet një ndërhyrje estetike, injektim botoksi për shtrirjen e rrudhave në fytyrë. Por ajo që na ka bërë pershtypje është se këngëtarja nuk ka ngurruar që këtë gjë ta ndajë me të gjithë ndjekësit në 'Instagram'. Fjolla e cilëson si një ndërhyrje të domosdoshme për të qenë sa më perfekte. Në fakt, personazhet e njohur shpesh detyrohen të shkojnë drejt perfeksionit për t'u shfaqur gjithmonë në formë përpara publikut. Dhe, pavarësisht ngurrimit, Fjolla e pranoi.



Per te qene me perfekt
treguar më parë se nuk ka këngëtares i është dashur t'i nënshtrohet një ndërhyrje estetike, injektim botoksi për shtrirjen e rrudhave në fytyrë. Por ajo që na ka bërë pershtypje është se këngëtarja nuk ka ngurruar që këtë gjë ta ndajë me të gjithë ndjekësit në 'Instagram'. Fjolla e cilëson si një ndërhyrje të domosdoshme për të qenë sa më perfekte. Në fakt, personazhet e njohur shpesh detyrohen të shkojnë drejt perfeksionit për t'u shfaqur gjithmonë në formë përpara publikut. Dhe, pavarësisht ngurrimit, Fjolla e pranoi.

E pranon më në fund! Fjolla Morina tregon ndërhyrjen në fytyrë



jam rritur njësoj si një fëmijë në një familje me të ardhura mesatare në Shqipëri.
Ledioni: Për shkak të dimensionit që Tani kishte dhe ka, njerëzit jo rrallë herë marrin përsipër të shkruajnë nëpër komente se çfarë do të ishte bërë ai ndryshe po të ishte akoma gjallë. Sa ndryshe do të ishte Jeta jote sikur ai të ishte akoma këtu?
Sara: Nuk mendoj që ekziston një njeri që e njihje atë aq mirë sa të marrë përsipër të thotë me siguri që çfarë do të kishte bërë ai sot. Unë mendoj që ç'ka për të ndodhur në jetë do të ndodhë, mund të vonohet, por është e pashmangshme. Që gjërat do të ishin ndryshe,

edhe mundet. Unë mbase nuk do të isha në Tiranë, do të vazhdoja studimet e mia jashtë. Nga mungesa e tij unë doja t'i qëndroja mamit afër, e më pas të gjeta ty erdhi London. Edhe nëse ai do të ishte, këto gjëra do të kishin ndodhur, mbase kur të isha 30 apo 35 vjeç. Është e tepërt të thash çfarë do të kishte bërë ai, sepse koha të ndryshon dhe njerëzit nuk e marrin parasysh shenjë e kohës.
Ledioni: A ishte London një surprizë?
Sara: London ishte me vetëdije të plotë. Ne kemi pasur një shtatzëni përpara London, që fatkeqësisht u ndërpre në mes, sepse zemra e bebbit push-

oi së rrahuri. Dua ta them këtë, sepse është diçka që u ndodh shumë njerëzve, është shumë e trishtë, por dua që të kuptojnë që nuk është përfundimtare ajo ndjesi. Ti e mban mend se sa u mërzitëm për një fëmijë që ishte sa një kikirik, që as nuk e njohëm, dhe aty e kuptuam sa shumë donim që të krijonim një familje tonën.
Ledioni: Le të tregojmë pak për kush ju vardis kujt?
Sara: Ti mua!!!
Ledioni: Pra, nuk ishte dashuri me shikim të parë? (qesh)
Sara: Jo, ishte dashuri pas 15 vitesh.
Ledioni: Po kur e kuptove ti që ishte dashuri, sepse unë të kam thënë i pari të dua.
Sara: Po, dhe unë në fillim ta thashë si përgjigje duke menduar se atë duhet të thosha. Nuk jam e sigurt nëse e ndjeja atëherë kur ta thashë për herë të parë. Por e kuptova 100% kur shkova në Londër dhe nuk rrija dot pa ty.
Ledioni: A do e tregosh momentin që ne gati jemi ndarë?
Sara: Kur historia jonë u bë publike dhe doli në çdo faqe online, unë isha në gjendje shoku. Nuk isha gati. Isha vetëm 18 vjeç, në një lidhje me dikë 10 vite më të madh se unë, që punonte tek kompania e familjes sime. Jemi ndarë për 3 ditë. Atëherë mendoja që ky ishte fundi. Unë isha një njeri shumë privat, ndërkohë kush nuk më shkruante për këtë histori. U futa në gojë e të gjithëve brenda natës, ishte e papritur dhe nuk e

kapërdija dot.
Ledioni: Po kush mendon se e ka vuajtur më shumë publikisht dhe profesionalisht bërjen e lidhjes publike?
Sara: Ti më shumë se unë, sinqerisht. Dhe për këtë më vjen keq. Por vetë zgjodhe goçen e pronares (qesh).
Ledioni: Po të ardhmen tënde a e mendon këtu?
Sara: Të ardhmen time të afërt e mendoj këtu, por edukimi që unë kam marrë jashtë Shqipërisë është shumë i rëndësishëm për mua. Edhe Londonit i duhet kjo eksperiencë. Dhe herët a vonë do na duhet të shkëputemi nga këtu, por si doqoftë nuk mendoj se do të jetë e përhershme.
Ledioni: A të mbetet mendja tek komentet negative dhe fytyrë në rrjetet sociale karshi teje dhe familjes tënde?
Sara: Të them të drejtën nuk kam parë shumë komente neg-

ative, por edhe sikur nuk i vë shumë peshë. Rëndësi për mua kanë njerëzit që kanë një rol në jetën time, me të cilët edhe konsultohem për vendimet e mia. Jetojmë në një kohë ku për mirë, apo për keq çdo njeri mund të thotë çdo gjë për çdokënd, pa ju dridhur as dora e as zemra, pa menduar se mund ta fyjë tjetrin (dhe fyerja është më e pakta), por me kalimin e kohës e shkel njërin sy.
Ledioni: A ka Lori më shumë ndikim tek ty, apo ke ti më shumë tek ajo?
Sara: Ne të dyja plotësisht mungesat e njëra-tjetrës. Jemi shoqja e ngushtë e njëra-tjetrës. Jemi si motra (qesh)...
Ledioni: Lori e ka provuar të punojë në "Top Channel" dhe të përfshihet në projekte të mëdha. Ti a e ke ambicien e të qenit në krye të "Top Medias" një ditë?
Sara: Sigurisht, por pasi unë të

kem përfunduar edukimin dhe kultivimin tim. Në ndryshim nga Lori, kjo s'ka qenë ëndërra ime. Asaj i vjen natyrisht. Për mua do ishte të rrezikojta nëse nuk e ndjeje veten gati. Unë shkoj gjithmonë me të sigurtën.
Ledioni: Çfarë të pëlqen më shumë nga "Top"-i sot?
Sara: Fakti që ka më shumë figura femërore se mashkullore në ekran. Nga mëngjesi deri në mbrëmje vonë, janë femrat ato që drejtojnë.
Ledioni: A ka Sara një master-plan për të ardhmen?
Sara: Dua të bëhem një avokate e zonja, pra jo nga këto që blejnë diplomën. Dua t'i përkushtohem me çdo gjë, sado e vështirë është. Dhe mbase të punoj diku në New York... një lloj Jessica Pearson prej vërteti.
Ledioni: Çfarë i trembesh më shumë?
Sara: Vdekjes! Jo times, por të familjarëve të mi...
Ledioni: A e vret mendjen ti për pamjen tënde?
Sara: Le të themi që nuk është fokusi im kryesor.
Ledioni: Çfarë më ke mësuar ti mua dhe çfarë të kam mësuar unë ty?
Sara: Unë të kam mësuar të jesh më i mirë dhe mirëkuptues karshi njerëzve që të rrethojnë. Ndonjëherë njerëzit thjesht gabojnë, por kjo nuk i bën ata të këqij. Ndërsa ti më ke mësuar të jem vetja, për mirë apo për keq. Të bëj çfarë mendoj unë se është e drejtë pa asnjë lloj pishmani.



BULEVARDI

Na merrni seriozisht. **POLITIK**

Ahmetaj raporton për buxhetin faktik, Braçe rri në celular gjithë kohën

Arben Ahmetaj dhe Erion Braçe treguan edhe njëherë tjetër se raportet mes tyre nuk janë në ditët më të mira. Ministri i Financave raportoi dje, përpara Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave për buxhetin faktik 2017. Por, ndryshe nga deputetët e tjetër të maxhorancës, Braçe duket se nuk ka qenë fort i interesuar për shifrat e Ahmetajt. Ai është parë teksa përdor telefonin celular, thuajse gjatë gjithë raportimit të ministrit. Ndërsa vlen të theksohet, gjithashtu, se si rrallë herë, Braçe ka mbërritur 30 minuta me vonë në komision. Deputeti i socialist tregohet më i vëmendshëm kur nis të raportojë përfaqësuesja e KLSH. Edhe javën e kaluar në interpelancën në Kuvend, Erion Braçe dhe Arben Ahmetaj replikuan për një sërë çështjesh, ndërsa nuk kursyen as ironitë ndaj njëri-tjetrit.



Në drekë pas përplasjes, Pollo: Shkova se s'doja të ofendoja Tajarin

Deputeti i Partisë Demokratike i përgjigjet reagimeve të shumta, ndër to edhe ironisë së kryeministrit Edi Rama, për prezencën në drekën e organizuar nga Parlamenti Europian, vetëm pak çaste pas përplasjes dhe bojkotit të komisionit të përbashkët. Pollo thotë se shkoi në drekë për të mos ofenduar organizatorët dhe presidentin e PE-së Antonio Tajarin, ndërsa ky i fundit "nuk kishte çfarë të bënte se ishte Taulant Balla aty". "Unë mora pjesë në atë drekë ku thjeshtë ishim të ftuar. Aty bëra unë atë deklaratë që bëra, në komisionin e përbashkët. Ajo është një eventiment protokollar, refuzimi i së cilës do të ishte i papërshtatshëm, ndërsa qëndrimi real mbahet në mbledhje", sqaroi Pollo.



'EFHARISTO', Kumbaro falënderon Bushatin në greqisht

Ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro ka bërë një falënderim në "Twitter" për ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati. Falënderimi është bërë për faktin se në Ambasadën Shqiptare në Athinë u janë garantuar më shumë shërbime qytetarëve. Por çfarë tërhoqi vëmendjen e të gjithëve, ishte fakti që Kumbaro e falënderon kolegun e saj në greqisht. "Për të gjithë miqtë e mi dhe miqtë tuaj, që jetojnë e punojnë në Greqi, @AlbanianDiplo, ju pret e ju shërben në kushte dinjitoze në ambasadën tonë në Athinë, se ju meritoni gjithë vëmendjen tonë @AIEmbassyGreece në gatishtëri @ditmirbushati Efharisto", shkruan Kumbaro. Ky postim i ministres solli mjaft reagime në rrjet.



Prindër për herë të parë, Xhaçka uron çiftin e ushtarakëve të Forcës Tokësore


Dy pjesëtarë të Forcës Tokësore janë bërë prindër për herë të parë. Çifti i ushtarakëve, Major Altin Hazizi 43 vjeç (komando) dhe Tetare Elona Qorri, 34 vjeç, pjesë e Kompanisë mbështetëse janë gëzuar me një vajzë, emri i të cilës është Mia. Në gëzimin e tyre mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila vizitoi nënën e re, në maternitetin "Kočo Gliozheni". Xhaçka i uroi të dy prindërit e rinj për fëmijën e parë. "Pastë jetën e gjatë dhe të lumtur!", u shpreh ministrja Xhaçka, ndërsa kishte edhe një dhuratë për vajzën e sapolindur. Fëmija i parë i dy pjesëtarëve të Forcës Tokësore erdhi në jetë në orët e para të datës 16 tetor dhe peshon 3.6 kg. Ajo gëzon shëndet të plotë bashkë me nënën.

Këshilla



Formula për femrën perfekte duket e thjeshtë në sipërfaqe: E nxehtë/seksi + e zgjuar + e qeshur = E duhura. Por studime pas studimeve na dalin gjëra dhe cilësi të reja që një femër duhet të ketë për të qenë idealja e mashkullit!

Fleura Shkëmbi
Psikologe, Hipnoterapiste Klinike



Meshkujt pëlqejnë femrat që qeshin me shakatë e tyre. Studiuesit kanadezë kanë gjetur se meshkujt tërhiqen më shumë nga femrat, të cilat qeshin me shakatë e tyre edhe kur ndoshta janë bajate. Nga meshkujt e pyetur, 75% thonë se sensi i humorit është karakteristikë që femrat duhet ta kenë. Turivarurat, negativet, janë të lodhshme. "Ma nxu jetën që nuk pëlqen asgjë", "Do shikojë vetëm të këqijat në çdo situatë", "Nuk durohet një femër e tillë gjithë jetën, se ta prish ditën që në mëngjes".

Buzëqeshja
Sipas një studimi të revistës "Emocion", meshkujt pëlqejnë më shumë femrat e qeshura ku dukeshin edhe pak dhëmbët, ndërsa femrat parapëlqyen më shumë meshkujt seriozë. Buzëqeshja konsiderohet si pjesë femërore, jo e egër, e brishtë dhe e nënshtuar/e bindur, e relaksuar dhe mirë me veten. Kush nuk do ta dëshironte një femër të tillë? "Ka një buzëqeshje që më çmend, më zbut sa herë që jam i nevrikosur", "Nuk e ngre dot zërin kur ajo më buzëqesh", "Më relakson sa herë shikoj fytyrën e saj të qeshur".

Meshkujt çmendën pas gjoksit të madh
Lajmi i njohur: Meshkujt pëlqejnë gjoksin e femrave! Lajm akoma edhe më i njohur: Meshkujt pëlqejnë gjoksin e madh! Sipas studimit del se meshkujt që pëlqejnë seksin që ju sjell rastit apo fati i momentit, ndikohen nga madhësia e gjoksit të femrës. Gjoksi i madh në të pavetdijshmen e meshkujve tregon pjellori, prandaj edhe tërhiqen nga madhësia, pa lënë mënjanë pamjen vizive që i jep gjoksi i madh formave të trupit të një femre. Revistat, imazhet dhe pornostaret janë pothuajse gjithmonë me gjoks të madh. Askush nuk e privon veten për t'i çuar sytë të një gjoksi i madh!

Këmbët e gjata janë joshëse
Në përgjithësi mendohet se njerëzit e gjatë janë më tërheqës se ata më të shkurtër, por kjo nuk është ap-

riori, sepse kemi raste që vërtetojnë të kundërtën. Mirëpo studimet tregojnë se meshkujt pëlqejnë femrat me këmbë të gjata. Arsyet mund të jenë individuale, ndërsa përgjigjja e përgjithshme: Duken më seksi! Meqenëse meshkujt çdo gjë e kanë të lidhur me dukjen seksi. Po t'iu themi se mund t'i ketë këmbët e gjata dhe të bukura, por gjatë seksit mund të jetë e ftohtë dhe arrogante, kë do zgjidhni ju në këtë rast?

Numri i këmbës tregon shumë

Po gjatë studimeve ka dalë që meshkujt pëlqejnë katër herë më shumë femrat me këmbë të vogël se duken më të bukura, gjë që na tregon se meshkujt e konsiderojnë këmbën e vogël si më femërore dhe më tërheqëse. Eh meshkujt, gjithmonë konfuzë në atë që duan: femër me këmbë të gjata dhe shputë të vogël nuk mund të jetë, sepse i bie të rrezohet rrugës dhe të mos ruajë ekuilibrin.

Femrat në karrierë konsiderohen seksi

Mendojnë vërtet që janë më seksi, apo parapëlqejnë që ato të kontribuojnë në buxhetin e familjes, sepse meshkujt e pyetur për partneret e tyre ideale shprehën se kërkojnë një femër që i fut të ardhurat e saj në marrëdhënie. Kanë filluar ta humbin instinktin e gjuetarit: femra në shpellë duke u kujdesur për zjarrin dhe fëmijët, e mashkulli në pyll! E cuditshme, se nga ana tjetër kërkojnë gjoksin e madh për pjellori?!

Inteligjenca rifreskon mendjen
Në gazetën e studimeve të




seksit, meshkujt raportojnë se ndihen më të kënaqur kur partneret e tyre janë të shkolluara, por nga ana tjetër raportojnë të jenë më të pakënaqur nga martesat kur shtylla e familjes është gruaja. Suksemi të bën të konsiderohesh si femër seksi, por me kujdes! Femra, jo shumë sukses, se na tremben meshkujt. Kanë frikë se u ikën pushteti nga duart, sepse janë të ndërgjegjshëm se ai që ka financaat ka pushtetin.

E kuja nuk i shpëton syrit
Meshkujt u vendosën përpara fotove me femra të cilat kishin veshur të brendshme të kuqe dhe një pjesë tjetër të bardha. Rezultati: meshkujt përcaktuan si më tërheqëse, më seksi dhe më të dëshiruara ato që kishin veshur të kuqe sesa ato me të bardha. Të gjithë e dimë se e kuja tregon potencë, forcë, sensualitet, ndërsa e bardha pastërti dhe brishtësi.
Flokët e zinj janë të preferu-



ar
Në një studim të bërë në 2011 në Angli, meshkujt i rendisnin zeshkanet si më tërheqëse fizikisht krahasuar me femrat kokëkuqe, bionde apo flokë kafe. Nga i njëjti studim doli se meshkujt i shikojnë zeshkanet

si më inteligjente, më kompetente dhe më të arritshme. Nga një studim tjetër në "Florida State University" doli se meshkujt i konsiderojnë flokëzëzat si më të besueshme, më serioze dhe më të qëndrueshme.



Femra ideale?! Çfarë mendojnë meshkujt

LIBRI

Fatmira Nikollë.

Kuvendime në mbretërinë e të vdekurve: bashkëbisedim midis Gjergj Kastriotit, mbretit në Shqipërisë dhe i Epirit, dhe Karlit të madh, perandor romak". Kjo është e vepra e shkruar nga abati Lorenzo Ignacio Thjulen në vitin 1816 dhe ribotuar në vitin 1832. Ajo është përkthyer nga Gemaj Kraja dhe vjen në gjuhën shqipe nga Botimet Françeskane. Arsyet se pse vepra u shkrua mbetet mjaft interesante edhe sot, kur ende rrekemi të gjejmë mënyra për të joshur të rinjtë drejt dijes. Ishte viti 1788, kur abati Thjulen i ishte besuar detyra për të dhënë mësim shkrim e lexim në shkollat fetare të Bolonjës. Me keqardhje, ai vuri re se nxënësit kishin njohuri të pakta rreth gjeografisë dhe historisë. Për të ndryshuar këtë gjendje, mendoi t'u përgatiste atyre disa studime për mëkimin e njohurive në këto fusha, gjë që u realizua me miratimin e eprorëve të tij dhe me pëlqimin e të rinjve. Duke marrë për bazë autorët latinë, ai do të krijonte një përmbledhje të vogël të historisë antike dhe për këtë, mendoi kthimin pas në kohë, që nga perandori Kostandini i Madh. Abati hartoi edhe një përmbledhje tjetër me dy vëllime, ku shqyrtoheshin një sërë të dhënash gjeografike. Kjo e fundit mbeti e pabotuar, pasi, sipas tij, zhvillimet politike do të sillnin vjetërimin e saj në pak muaj. Një shënim hyrës i botimit, vëren se megjithëse Italia ishte toka me më shumë dijetarë dhe histori, ai vuri re se të rinjtë italianë, në ndryshim nga kombet e tjera, ishin gjithmonë e më pak të interesuar për historinë e vendit të tyre. Sipas mendimit të abatis, si autor tashmë, kjo vinte nga mungesa e tregimeve të përmbledhura në tekstet mësimore për të rinjtë. Sipas tij, nëse një fëmijë të moshës 12 – apo 14-vjeçare do t'i paraqitej një tekst voluminoz për historinë, mosinteresi ndaj saj do të ishte i pritshëm. Ndaj ai mendoi për një metodë që mund të tërhiqte të rinjtë dhe në fund, zgjodhi atë që i paraqitet më poshtë lexuesit. "Një ndër arsyet kryesore të kësaj zgjedhjeje ishte shtjellimi i dialogut në përpjesëtim me argumentin, duke sjellë kështu një lexim të kënaqshëm. Së dyti, autori ishte i mendimit se historia e kohëve të ndryshme kuptohet më së miri nëse shihet nga këndvështrimi i jetëve të ndritura të figurave që lulëzuan në periudha të ndryshme", thuhet në tekstin shoqëruar të botimit. Sipas tij, edhe vetë kritika, e cila shpesh është e mërzi-shme, vjen natyrisht në dialogun historik kur një bashkëbisedues i kërkoi tjetrit sqarime. "Karakteret i njerëzve nxirret në pah më mirë, pasi në mbretërinë e të vdekurve askush nuk ka drojë të rrefëje gabimet e tij. Ndryshimet në mendime dhe mosdakordësitë sipas ndodhjeve, shërbejnë për të kuptuar fenë dhe ndershmërinë. Shpesh u lihet vend edhe rrurëzave, për ta bërë leximin më të këndshëm. Vendosja e bisedave në mbretërinë e të vdekurve nuk është sjasëje e re, pasi ajo është përdorur nga sh-

VEPRA E 1800-ës

Biseda e Skënderbeut me perandorin romak Karl

Unë të kam shërbyer dhe të kam kryer kaq shumë detyra të besuara. Ti ke vuarë vëllezërit e mi, ke rrëmbyer mbretërinë atërore dhe thure për mua vdekjen më gjakatare.

krimtarët e antikitetit dhe shkruantët modernë, por nuk e dimë nëse ndonjëri prej tyre e ka përdorur këtë për të paraqitur një histori të rregullt", thuhet në tekstin hyrës. Kjo histori fillon me mbretërimin e Karlit të Madh dhe vjen deri në ditët e sotme. Sipas abatis, njohja më e mirë e së shkuarës sjell zbardhjen e fakteve që nuk janë fort të qarta nëse nuk njih vendin. Ndokujt do t'i dukej se bashkëbisedimi nuk do të mund të përshtatej mirë me historinë ose, së paku, me një histori që u prezantohet njerëzve të qytetëruar. Por ç'mund të jetë më edukuese, e kënaqshme dhe sublime sesa një dramë e bukur, e duke menduar se çfarë është në thelb ajo, përveç se një fakt historik i vendosur në një bashkëbisedim.

PJESË NGA LIBRI

Karli i Madh

Për një despot oriental dhe të acaruar, letra nuk është e konceptuar keq. Sidoqoftë, nuk mund të ketë mbetur pa përgjigje nga ana juaj.

Skënderbeu

Unë iu përgjigja:

Gjergj Kastrioti, luftëtar i Krishit, i mbiquajtur Skënderbe, princ i epirotëve dhe i shqiptarëve për Muratin, princ i turqve, të fala! Kam marrë mesazhin dhe letrën tënde, në të cilën më ke fyer në të tillë mënyrë, që të provokojë qetësinë time dhe të ta ktheja me të njëjtën monedhë. Ashtu edhe unë, Murati, nuk dua të bëj të njëjtën gjë me ty, por me fjalë të thjeshta të të paralajmëroj dhe të të them disa gjëra që i përshtaten moshës tënde. Ti më akuzon për pabesi dhe tradhti, si edhe përse mora përsëri mbretërinë e babait, që ti gëzoje pa të drejtë. Por në këtë pikë ke pak vërtetësi dhe arsye. Ti numëron mirësitë dhe përfitimet që kam marrë nga ti, të cilat në të vërtetë i pranë, por me përpjekjet e mia të mëdha, kujdesin, vështirësitë, syçellësitë dhe akoma më tepër, me rrezikje të skajshme të nderit dhe të jetës sime, unë të kam shërbyer dhe të kam kryer kaq shumë detyra

Botimi i abatis Lorenzo Thjulen në shqip, personazhet historike në letërsi



të besuara. Ti ke vuarë vëllezërit e mi, ke rrëmbyer mbretërinë atërore dhe thure për mua vdekjen më gjakatare. Tani të duket e çuditshme që një shpirt, i cili e ka lirinë të shenjtë, kërkoi të shkundë zgjedhën e robërisë?! Deri në ç'pikë

mendoje se unë mund të duroja një sundim kaq të tmerrshëm? Çdo ditë thureshin dredhi të reja kundër meje. Nuk dyshoja mashttrim në fjalët e tua, deri kur u vetëkuptua dhe u binda. I shmanga deri kur m'u dha mundësia të rifitoja lirinë time. Ajo që kam bërë deri tani është pak në krahasim me atë që shpresoj të bëj. Lëri kërcënimet, të cilave nuk u druham. Unë besoj në mbështetjen hyjnore. Ki parasysh, pra, se unë nuk kërkoi këshilla nga armiqitë e mi, as paqe me ty, por fitore nga Perëndia! Ji mirë! Nga kampi ynë, 12 gusht 1444.

Hungarezët e kishin thyer armëpushimin me turqit dhe për këtë me erdhi mirë, sepse përndryshe turqit do të më kishin hapur shumë punë. Murati, i cili kishte një ushtri të shkëlqyer, duhet të

përballej me ta, ndaj nuk mund të dërgonte tek unë më shumë se 10 000 vetë. I lashë të kalonin pa asnjë pengesë deri në Epir, por me të arritur atje, i sulmova sikurse një luan gjuan prenë e vet, mes pyjesh, malesh dhe ngushticash, ku kalorësia që formonte pjesën më të madhe, nuk mund të vepronte. E gjithë trupa mbeti me 800 vetë, të cilët lëshuan armët dhe u dorëzuan. Më tej, bëra një kundërvizitë në tokat turke, duke i lënë të mitë të bënin tërë plaçkitjet e mundshme. Por, në të njëjtën kohë, turqit kishin hyrë në vendin tim me një tjetër ushtri, nga një anë tjetër. Ata e keqtrajuan atë jash-tëzakonisht. Një fshatar epirotas hipi në kalë dhe erdhi të më tregonte për zjarret dhe kërditë që po bënin armiqitë. Ai m'u ul në gjunjë, duke m'u lutur të shkoja t'i indimoja. U nisa menjëherë dhe iu hodha turqve më parë nga ç'e prisnin. I munda dhe u mora atyre të gjitha plaçkitjet që kishin bërë. Trupa komandohej nga Mustafa Pasha. Kur arrita atje, ai po qëndronte në një llogore, ku nuk mund të përdroshin armë zjarri, por vetëm armë të ftohta. Ushtarët arritën deri aty sa të kapeshin prej flokësh dhe të kafayteshin. Pavarësisht këtyre fitoreve, në fushatën e vitit 1444 gjërat nuk ishin fort të favorshme për mua, sepse hungarezët pësuuan disfatë të plotë në Varnë, aty ku qëndronte ende mbreti i tyre, Ladislavi. Unë druhesha se mos tërë forcat e turqve mund të më viheshin kundër.

Veç kësaj, isha i përfshirë në një luftë me venedikasit. Kjo për shkakun e një marrëveshjeje me Lekë Zaharian, zot i Danjës. Në këtë marrëveshjeje dëftohej se unë do të isha pasardhës i vendit të tij, nëse ai do të perëndonte pa trashëgimtarë. Pasi ai u vra babisht nga njëfarë Lekë Dukagjini, i cili shpëronte që të bëhej zot i atij vendi, nëna e Zaharisë, e zgjedhur pas vdekjes së të birit për të sunduar, ua dorëzoi pas pak kohësh vendin e saj venedikasve. E quajta këtë dhuratë si të pavlefshme dhe e bllokova për disa kohë qytetin e Danjës. Venedikasit më sulmuan me 15 000 burra, ndërsa unë shkoja në luftë kundër tyre me 8 000. Formova rendin e betejës, e cila ishte mjaft e përgjakshme. Po ashtu, mësova se nuk kishte të bënte me turqit. U përdorën armët e ftohta, por venedikasit u mbrojtën gjatë, deri sa unë më disa grupe u futën me tyre duke i orientuar. Me gjithë ato që pësuam, ata sërish riorganizoheshin. Duke u futur sa andej-këtej në batalionet e tyre, u shkaktova në fund një humbje të madhe dhe i detyrova të largoheshin.

“Letër sulltanit nga kampi: Tani të duket e çuditshme që një shpirt, i cili e ka lirinë të shenjtë, kërkoi të shkundë zgjedhën e robërisë?!”

VENDIMI I QEVERISË

Qendra historike e Tiranës, një VKM për zonën e mbrojtur


Fatmira Nikolli.

Një Vendim i Këshillit të Ministrave që mban datën 3 tetor ka në fokus “Deklarimin e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit që i bashkëlidhet”. Dokumenti i publikuar në Fletoren Zyrtare (që hyn në fuqi menjëherë), është një “plan për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrës historike të Tiranës dhe zonës mbrojtëse të saj”. Dokumenti në fjalë do të dojë në vijim komentet e specialistëve të Ministrisë së Kulturës dhe oponentëve, por në parim ajo përcakton se hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Tiranës përbëhet nga Qendra Historike, Zona mbrojtëse dhe Zona arkeologjike A e Kalasë së Tiranës.

Brenda këtyre zonave përfshihen ansamble historike urbane, monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë, zona me potencial arkeologjik, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status. Po parimisht, thuhet se plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Tiranës merr parasysh kufijtë e zonifikimit të Qendrës Historike, zonës së mbrojtur të saj dhe zonës arkeologjike A, të Kalasë së Tiranës, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre. Në VKM vihet në dukje se Qendra Historike në qytetin e Tiranës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike-arkitektonike, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit dhe arrijtë në arkitekturë, si xhamia e Et'hem Beut, ndërtimet administrative dhe kulturore, të aksit monumental të viteve '30-'40, si dhe shembuj të spikatur të arkitekturës të pas viteve '50. Hapësira urbane e Qendrës Historike në qytetin e Tiranës përfshin Ansamblin historik urban në bulevardin “Zogu I” dhe bulevardin “Dëshmorët e Kombit”; Sheshin “Skënderbej”, Sheshin “Nënë Tereza”; Sheshin “Italia” dhe hapësirat e gjelbra.

QENDRA HISTORIKE DHE NDRËHYRJET

Vendimi përcakton se zona mbrojtëse shtrihet përreth Qendrës Historike, ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e qendrës historike. Vëren se në të ndodhen objekte monumente kulture të kategorisë së parë dhe të dytë dhe objekte pa status; vëren se zona arkeologjike A e Kalasë së Tiranës ndodhet brenda zonës mbrojtëse të Qendrës Historike të qytetit të Tiranës dhe se rregullat për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonës arkeologjike A, përcaktohen me plan të



veçantë. Neni 6 mbetet për t'u parë me interes, sepse ai përcakton ndërrhyrjet në Qendrën Historike. Parimisht thuhet se ndërrhyrjet në Qendrën Historike kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Brenda kësaj qendre kryhen:

a) Ndrëhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në qendrën historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive, bazuar në kriteret për konservimin dhe restaurimin; b) Ritrajtme, rikonstruksione dhe rifunksionalizim të objekteve me status, duke respektuar kompozimet dhe pamjen e jashtme, si dhe tërësinë e ansamblit arkitektonik urban; c) Ndrëhyrjet rehabilituese në rrjetin rrugor, sheshe dhe hapësira të gjelbra, duke ruajtur kompozimin urban; ç) Ndrëhyrje (rindërtime, rikonstruksione, rehabilitime) në objektet pa status, në përputhje me “Planin e përgjithshëm vendor” të qytetit të Tiranës.

Ndërkaq, neni 7 merret me “Ndrëhyrjet në zonën mbrojtëse”, ku sipas VKM-së, në këtë zonë kryhen restaurime, adaptime, rikonstruksione dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj arkitektonike dhe funksionale, të cilat duhet të jenë në harmoni me vlerat e ansamblit, por, lejohet edhe ndërtim, rikonstruksion i rrjetit rrugor dhe i shesheve, për përmirësimin e infrastrukturës.

Çfarë do të thotë kjo? Nëse kalaja është qendër historike, zona përreth saj, është zonë mbrojtëse dhe në të lejohen ndërrhyrjet e mësipërme. Neni 8 vendos që projektet e restaurimit të monumenteve të kulturës hartohen nga institucione shtetërore të specializuara ose nga subjektet të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, në vijim “KKTKM”. Zbatimi i punimeve të restaurimit kryhet

Mbrohet qendra historike, lejohet ndërtim, rikonstruksion i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e infrastrukturës së zonës mbrojtëse.

nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, në vijim DRTK-ja ose subjekte të licencuara për këtë kategori ndërtimesh. Thuhet se studimet dhe projektet e rikonstruksionit në qendrën historike hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në vijim IKTK-ja, DRTK-ja ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve. Projektet shqyrtohen dhe miratohen paraprakisht në KKTKM dhe vijojnë procedurën përkatëse sipas ligjit për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara për këtë

kategori. Studimet dhe projektet për ndërrhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushat përkatëse, në bashkëpunim me IKTK dhe DRTK.

Sa u takon studimit, projektimit dhe zbatimit të punimeve në zonën mbrojtëse vendoset që “projektet e ndërtimeve të reja, rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit”, si edhe “studimet dhe projektet për ndërrhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushat përkatëse. Projektet shqyrtohen dhe miratohen sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

ÇFARË ËSHTË NË MBROJTJE

Në VKM vihet në dukje se Qendra Historike në qytetin e Tiranës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike-arkitektonike, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit dhe arrijtë në arkitekturë, si xhamia e Et'hem Beut, ndërtimet administrative dhe kulturore, të aksit monumental të viteve '30-'40, si dhe shembuj të spikatur të arkitekturës të pas viteve '50. Hapësira urbane e Qendrës Historike në qytetin e Tiranës përfshin Ansamblin historik urban në bulevardin “Zogu I” dhe bulevardin “Dëshmorët e Kombit”; Sheshin “Skënderbej”, Sheshin “Nënë Tereza”; Sheshin “Italia” dhe hapësirat e gjelbra.

Më tej për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministritë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara. Shkelja e kësaj rregulloreje, thotë VKM, ndiqet nga dispozitat e ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

SHQIPËRIA FESTON 60 VJET NË UNESCO

Shqipëria ka festuar 60 vjet si anëtare e UNESCO-s. Në një aktivitet të organizuar për këtë përvjetor ishin të pranishëm ministrat Bushati, Kumbaro, Klosi e Nikolla. Krahas disa zonave që kanë pasaportën e trashëgimisë botërore, rajoni i Ohrit është dosja e radhës që po shqyrtohet. Duke e vlerësuar rëndësinë e këtij anëtarësimi, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati shprehu angazhimin e Shqipërisë për të qenë në linjë e parë të përpjekjeve, për të forcuar bashkëpunimin mes vendeve të rajonit përmes nxitjes, evidentimit dhe konsoli-

dimit të trashëgimisë së përbashkët kulturore, shpirtërore dhe diversitetit kulturor. Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro, në fjalën e saj e konsideroi gati formale praninë e Shqipërisë në 30 vjetet e parë, sepse sipas saj gjithçka nis me njohjen e vetes dhe tjetrit. “Ishte e vështirë vendosja e kësaj rruge komunikimi me UNESCO-n në lëmin e para viteve nëntëdhjetë. Ishte komunikim i pjesshëm, i cunguar dhe i pavërtetë. Kjo ishte edhe arsyeja pse hapi i parë domethënës me UNESCO-n erdhi në vitin 1992 me pranimin e Butrintit në shtet e mbrojtura të trashëgimisë botërore”, tha Kumbaro. Parku kombëtar i Butrin-

tit u shpall Monument Kulturor në vitin 1948. Në vitin 1992 u përfshi në listën e pasurive Botërore të UNESCO-s. Kodiku i Purpurt i Beratit është pjesë e UNESCO-s, si Memoria e botës. Isopolifonia shqiptare, pjesë e trashëgimisë shpirtërore është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Shpirtërore të UNESCO-s më 25 nëntor të vitit 2005.

Ndërsa ministrat Klosi dhe Nikolla u ndalen tek rëndësia e prezencës së organizatës në vendin tonë dhe projektet e rëndësishme që janë ndërmarrë në këtë kuadër, qofshin ato në politikat mjedisore apo arsimore.

Opinion i Ditës

Xhamia që meriton Prishtina dhe rreziku i përsëritjes së gabimit të Tiranës


NGA ADRI NURELLARI

(vijon nga faqja 1)

... e Bashkësisë Islamike të Kosovës, kjo xhami e re do të ndërtohet duke kopjuar arkitekturën e xhamisë së Sulltan Selimit II në Edirne që arkitekt Sinani ka pas ndërtuar në periudhën 1569-1575. Në këtë mënyrë përsëritet gabimi i Tiranës duke e privuar qytetin nga mundësia e pasjes së një objekti publik madhështor me arkitekturë origjinale bashkëkohore.

Së pari, duhet thënë që me komunitetin mysliman në Tiranë ashtu sikurse në Prishtinë është bërë një padrejtësi duke e vonuar kaq shumë ndërtimin e një xhamie të madhe. Xhamia qendrore e Prishtinës, ashtu sikurse edhe kjo e Tiranës janë vonuar si pasojë e një kompleksi inferioriteti të kombinuar edhe me nuancë islamofobie nga e cila ka vuajtur një pjesë e elitës shqiptare. Qeverisjet e njëpasnjëshme lokale të Tiranës, të të gjitha kraheve politike, kanë refuzuar për dy dekada të tranzicionit që të japin lejen e ndërtimit për xhaminë e madhe të Tiranës për të cilën është bërë kërkesë që në 1993. Edhe pse nuk e kanë shprehur haptazi, këta drejtues të qeverisë lokale duke dashur të duken "më katolikë se papa" kanë refuzuar që të ndërtohet një objekt i madh kullë islamik nga frika se mos binte keq në sy të huajve. Ka qenë për të ardhur keq fakti që myslimanëve, që përbëjnë shumicën në Tiranë, nuk u lejohet ndërtimi i xhamisë së madhe në tokën e zotëruar prej Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ndërkohë që Katedralja katolike e Shën Palit u ndërtua në fund të vitit 2001 ndërsa Katedralja Ortodokse "Ngjallja e Krishtit" u përfundua në vitin 2012, që të dyja në tokë shtetërore. Ky diskriminim i hapur është përdorur shpesh si evidencë nga klerikët radikalë për të kultivuar ndjesinë e viktimitizimit dhe getoizimit tek shumë besimtarë myslimanë.

Mirëpo situata sot është bërë edhe më absurde, sepse u kalua në ndryshim 180 gradë nga pengimi i ndërtimit të xhamisë prej "turpit" të dimensionit oriental tek ndërtimi i një xhamie me arkitekturë osmane mesjetare. Rama u kujtua për të lejuar ndërtimin e Xhamisë së Madhe të Tiranës vetëm në fund të mandatit të tij të tretë si kryetar bashkie, pak javë para zgjedhjeve të vitit 2011. Asokohe u bë një konkurs ndërkombëtar që u fitua nga projekti spektakular i danezët Bjärke Ingels, i cili sot konsiderohet si një ndër arkitektët bashkëkohor më të mirë në botë. Mirëpo për arsye banale politike Basha sapo e zëvendësoi Ramën në krye të bashkisë, e anuloi projektin modern të xhamisë dhe e zvarriti edhe më tutje këtë çështje. Drita e gjelbër finale për xhaminë u dha pak javë para zgjedhjeve të parlamentare të vitit 2013 ku edhe u miratua projekti otoman që po ndërtohet



sot. Prandaj unë po shpresoj që Prishtina të nxjerri mësim nga pësimet e Tiranës duke mos ndërtuar një xhami me arkitekturë osmane të para 6-7 shekujve, por një xhami të denjë për shekullin 21.

I njëjti gabim u bë edhe me ndërtimin e katedrales katolike të Prishtinës "Nënë Tereza". Ajo përveçse u ndërtua e stër-madhe në kundërshtim me atë që ishte parashikuar nga plani rregullues urban, u ndërtua në stil arkitekturor romanesk që i takon mesjetës. Idealja do të ishte që edhe arkitektura e katedrales të ishte bashkëkohore dhe objekti të mos ishte i atyre përmasave të ekzagjeruara që e bën të stonjë me pjesën përreth. Një tjetër gjë që e bën më qesharake situatën, është fakti që aty ku duhet me të vërtetë të vlerësojmë e kujdesemi për trashëgiminë otomane, tregohet neglizhencë. Kjo pasi në Kosovë ka rastisur që të prishen xhami shekullore otomane autentike për t'u transformuar e zmadhuar. Për mos të folur pastaj se si nuk tregohet kurrfarë kujdesje për të konservuar apo restauruar trashëgiminë monumentale osmane të qyteteve të ndryshme të Kosovës duke nisur nga garshia e Prishtinës.

Duhet thënë që arkitektura osmane ka qenë pararojë për kohën e vetë dhe arkitekti më i shquar i këtij stili, Sinani, është konsideruar si Mikelandhelo i Lindjes. Mirëpo po ashtu, duhet kuptuar se ajo arkitektura nuk ishte gjë tjetër përveç se arkitektura e mëparshme bizantine e ndryshuar duke gërshtetur nuancë stilistike nga Azia Qendrore dhe Lindja e Mesme. E theksoj këtë fakt për të treguar se xhamitë nuk duhet që të jenë medoemos me arkitekture otomane për t'u konsideruar xhami të denja pasi baza e kësaj arkitekture është faktikisht Bizantini kristiano-ortodoks.

Arkitektura fillestare e xhamive kuptohet që ishte arabe, pasi xhamia e parë thuhet të ketë qenë shtëpia e profetit Muhamed, e cila ka shërbyer si xhami në shekullin VII. Ajo kishte karakteristika tipike të një shtëpie arabe: një oborr i gjërë i rrethuar nga dhoma të gjata të mbështetura nga shtylla. Mirëpo islami duke u

përhapur nëpër botë mori stile arkitekture lokale nga më të ndryshmet duke variuar nga stili turk dhe pers tek malaj, hindu e kinez. Kjo do të thotë se arkitektura e xhamisë varion sepse është formuar kryesisht nga traditat vendit ku është ndërtuar dhe teknologjisë së kohës.

Për të qenë xhami e pranueshme për liturgjinë, klerin dhe besimtarët, një ndërtesë duhet thjeshtë të ketë disa elemente bazike e mandej stilet arkitekture mund të jenë ç'të duan. Këto elemente janë oborri apo sahani që nënkupton një sallë lutjesh; muri i kiblës që tregon drejtimin e Kiblës; mihrabi që është një thellim gjysëmçarkor në murin e xhamisë që tregon kiblën; kupola apo kubeja që simbolizon kupën e qiellit dhe minarja apo kulla nga ku bëhet thirrja për lutje. Gjithashtu tipike për xhami janë minberin ose foltorja e hoxhës si dhe dekorimet.

Kosova është shteti më i ri në Evropë dhe, gjithashtu, ka popullsinë më të re në Evropë, e nuk ka përse të mbetet peng i së kaluarës. Prishtina meriton një xhami që të jetë ajka e arkitekturës ndërkombëtare sot sikurse që avangardë arkitektura osmane në kulmin e saj kur edhe u ndërtua Xhamia Blu (Sulltan Ahmet) nga arkitekt Sedefqar Mehmeti Biçakçiu i Elbasanit. Përderisa ne përfitojmë nga arrijtet e njerëzimit, nga teknologjia moderne duke përdorur makina, avionë e iphone, përse duhet që të ndërtojmë ndërtesa që i përkasin një epoke kur njerëzit përdornin vetëm kuaj e deve. Arkitektura e asaj kohe, ish- u e kushtëzuar nga nevoja, botëkuptimi, shija, teknologjia e kohës ndërkohë që sot të gjitha këto elemente kanë ndryshuar radikalisht. Stilet arkitekture me të cilat ndërtojmë, sikurse edhe zhanret e tjera artistike si muzika apo piktura, pasqyrojnë kulturën, shijet, nevojat e shoqërisë që i krijon. Arti mund të konsiderohet si një gjuhë që në mënyrë të pashmangshme evoluon me kalimin e kohës. Ne nuk vishemi më me fustanella, tirçe, çiftjane e xhubleta si në kohën kur u ndërtuan xhamitë otomane, atëherë përse duhet të ndërtojmë në stilin e atëherëshme duke

shpërfillur ndryshimet që kanë ndodhur në shoqërinë tonë prej asaj kohe.

Për këtë gjë fundja nuk ka nevojë që të shpikim rrotën, por të veprojimë siç kanë vendosur të veprojnë vende të tjera të botës që e kanë shumicën e popullsisë myslimane. Kështu për shembull xhamia më e madhe në Pakistan, xhamia Faisal është ndërtuar me arkitekturë moderne në 1987 dhe po ashtu xhamia Negaranë Kuala Lumpur, quajtur ndryshe xhamia kombëtare e Malajzisë është ndërtuar me stil modern në 1965. Indonezia dy xhamitë më të mëdha të saja, atë të Sumatras Perëndimore dhe Istiqlal në Xhakartë, i ka, gjithashtu, mban firmën e arkitektit britanik John McAslan. Xhamia e Madhe e Algjerit, që është duke u ndërtuar në Algjeri dhe që ka për t'u bërë xhamia e tretë më e madhe në botë, është dizajnuar me arkitekturë moderne nga kompania gjermane KSP Jürgen Engel. E njëjta gjë mund të thuhet për projekte madhështore moderne arkitekture si Xhamia e Parkut Lindor në Manama të Bahreinit, xhamia Abdul Rahman Siddique në Dubai, xhamia KAFD dhe ajo KAPSARC në Riad të Arabisë Saudite, Baitur Rauf Jame në Daka të Bangladeshit, Yesil Vadi dhe "akirinnë Stamboll, Assyvaah në Singaporë etj. Anëmban Evropës gjithashtu janë ndërtuar xhami që janë perla të arkitekturës moderne sikurse janë Qendra Islamike dhe Xhamia në Rjekë të Kroacisë, xhamitë e Këlnit dhe Penzbergut, Nusrat Xhahan në Kopenhagen të Danimarkës, Baitur Futuh në Londër etj. Por ka edhe raste shqiptare, sikurse është xhamia e Ballies në Elbasan, e cila është duke u ndërtuar me një arkitekturë shumë të hijshme bashkëkohore e që është mirëpritur me kënaqësi nga banorët e të gjitha feve.

Përveç se për klerikët dhe besimtarët myslimanë, objekti i xhamisë së re të Prishtinës ka rëndësi edhe për mbarë shoqërinë, sepse do të jetë një ndër ndërtesat publike më të mëdha. Fatkeqësisht Kosova ka pasur shumë shanse të humbura për të ndërtuar ndërtesa publike të mëdha me arkitektë të

njohur ndërkombëtarë, mirëpo janë zgjedhur arkitektë mediokër "me të njohshëm". Prandaj nëse do të përzgjidhej një projekt bashkëkohor për Xhaminë Qendrore të Prishtinës, sikurse është ai i Zaha Hadid, Prishtinës do i përmirësohej reputacioni e do i shtohej edhe një atraksion turistik. Arkitektët e famshëm si Hadid janë shndërruar në marka apo brande më vete dhe krijimet e tyre të viteve të fundit. Kështu, për shembull, qendra Heydar Aliyev E Zaha Hadid në Baku të Azerbajxhanit është një ndër destinacionet kryesore për turistët. Kështu mund të thuhet se janë shndërruar në ikona për qytetet përkatëse Guggenheim Museum në Bilbao apo Shtëpia Vallëzuese në Pragë të Frank Gehry-t, **Buri Al Arab** në Dubai nga Tom Wright, Kulat Petronas në Kuala Lumpur nga Cesaro Pelli, Marina Bay Sands nga Moshe Safdie, Qyteti i Artit dhe Shkencës në Valencia nga Calatrava, Reichstag në Berlin i Norman Foster etj.

Përpos kësaj nuk ka përse medoemos të ndërtohet në qendër të Prishtinës kjo xhami. Prishtina është një qytet në zhvillim e sipër dhe tendenca e qyteteve moderne është që të jenë policentrike, për ta shpërndarë ngarkesën e trafikut por edhe mirëqenien ekonomike në mënyrë sa më proporcionale nëpër gjithë hapësirën urbane. Pikërisht për këtë arsye do të ishte me vlerë që kjo xhami kur të ndërtohet mos të cenojë trashëgiminë arkitektonike të Prishtinës, ashtu si është ajo moderniste e ish-komuniste, por të ndërtohet në pjesët e reja në zgjerim të qytetit sikurse janë Lakrishtja apo Rruga B. Prishtina dhe mbarë Kosova, qoftë si pasojë e luftës e qoftë e zhvillimit e vullshëm e të shkuajtur urban që pasoi, ka humbur shumë nga trashëgimia e saj monumentale, prandaj është mirë që jo vetëm trashëgimia otomane e qendrës e lënë pas dore, por edhe komplekset e ndërtimeve të periudhës së Jugosllavisë të rishqyrtohen me sy historiani dhe të merren në mbrojtje e mirëmbahen.

Së fundmi ka edhe një element shumë të rëndësishëm ideologjik tek nevoja për një stil arkitekturor modern e që ka të bëjë me dimensionin universal të fesë islame që hamendësohet të jetë e vlefshme për çdo kohë. Pra një stil arkitekturor modern lë të kuptohet se feja islame nuk i përket vetëm të kaluarës por edhe të tashmes e të ardhmes. Gjithashtu, një arkitekturë bashkëkohore që është etnikisht neutrale, i jep goxha më shumë legjitimitet e besueshmëri xhamisë më të madhe në Kosovë, sesa po të ndërtohej në stil osman, i cili mund konsiderohet nga shumë zëra si reminishencë e ish-pushtuesve. Për një shoqëri të re si e Kosovës ku rinia mezi pret të bëhet pjesë e botës së zhvilluar, është e arsyeshme që edhe bashkësia islame të komunikohet e bëhet tërheqës për brezat e rinj, mes të tjerash nëpërmjet arkitekturës moderne të objekteve të kultit, duke dhënë kështu mesazhin se ky institucion di të eci në hap me kohën.

Opinioni *i* Ditës

SHPIFJA, beteja e GABUAR!

Nga Lutfi Dervishi

(vijon nga faqja 1)

... thashetheme, gënjeshtër, fy-erje, tallje, përqeshje.

Kjo është bota ideale.

Bota reale është pak a shumë ajo që parashikonte Aldous Huxley në vitin 1931 kur shkroi novelën "Bota e re e marrosur".

Huxley, ndryshe nga bashkëkohësi i tij George Orwell që në vitin 1948 shkroi romanin e famshëm "1984", ku parashikonte një shoqëri që do të ndalonte informacionin - ishte më profetik. Huxley thoshte se jo vetëm që nuk do të ndalohej informacioni, por do të ketë cunam informacioni.

Orwell thoshte se e vërteta do të ndalohej, Huxley thoshte se e vërteta do të zhytet në oqeanin e kotësisë. Orwell parashikonte që individi do të torturohet, Huxley thoshte se "tortura" do të injektohet përmes kënaqësisë.

Përpjekja e qeverisë për të ndaluar shpifjen me paketë i ngjan përpjekjes së laboratorit më të mirë britanik që nuk arriti të ndaj dot "sinjalin" nga zhurma babale.

Të rrësh me median sot është një nismë shumë e guximshme.

Media nuk është ajo që ka qenë. Nuk është e lehtë të japësh përgjigje për pyetjen: kush është media? Kush është gazetar?

Është gazetar gazetari tradicional që beson se do të ndryshojë botën me punën e tij, ndërkohë që bota po ndryshon vetë me një shpejtësi marramendëse?

Është gazetar çdo njeri me celular në dorë që prodhon tekst, foto video apo kombinim të tyre?

Është gazetar, moderatori/moderatorja e njohur që të mahnit me pyetje të tipit: çfarë mendon për... kohën/raketat/babalen/rrugën e kombit/FMN/ITrump/shkollën etj. etj. etj.?

Është gazetar ai/ajo që (sipas zëvendësministrit të Brendshëm) është vënë në shërbime të bandave kriminale rivale?

Është gazetar këngëtarja e njohur që ka miliona klikime në you tube?

Është gazetar/e kryeministri? Kryetari i Partisë? Ministri? apo kryebashkiaku që raportojnë për veten përmes medias sociale?

Është gazetar - ai/ajo që i shërben si kamerier/kameriere pushtetit të radhës?

Është gazetar ai i marri që nuk e dëgjon njeri në shtëpi, që e tallin në lagje, por që jep leksione në ekran?

Është gazetar ai që punon me "qira" në këtë profesion?

Është gazetar ai që punon në televizion kombëtar dhe ka 3 muaj pa marrë rrogën?

Është gazetar ai i marrëdhënieve me publike që informacionin e paketon si lajm dhe do ta shesë përmes televizionit?

Është gazetar/e ai/ajo që ka alergji nga e vërteta?

Situata në lidhje me median ka ndryshuar dhe jo vetëm në Shqipëri. Opinioni publik nuk ndikohet më vetëm përmes medias tradi-



cionale dhe gazetarëve, por edhe prej rrjeteve sociale. Fuqia e individëve të pafuqishëm deri dje që shprehin lirshëm mendimet e veta është gjithnjë në rritje. Aty ku media tradicionale merrmerit, media e re ulërit dhe shpesh me të drejtë.

Për shkaqe historike ne nuk jemi ende shoqëri informacioni, por jemi shoqëri thashethemi. Kemi frikë të lexojmë të vërtetën, sepse druajmë se do të na ndryshojë mendje. Më lehtë besohet thashethemi më i pabesueshëm se e vërteta që të zë sytë.

Nuk ka rast të dytë në kontinent që në "prime time" çdo natë të kesh nga 10 programe me politikë. Nëse "politika" do të eksportohet ne do të ishim vendi parë eksportues në glob.

Ata që zotërojnë median (tradicionale) sot nuk janë filantropë që i kanë zënë ethet e dashurisë për të treguar ngjarjet e ditës dhe historinë, ata i kanë zënë ethet e parasë dhe median e kanë për të bërë më shumë pare, për të ushtruar më shumë pushtet, për të dëshmuar më shumë vanitet!

Në epokën e cunamit të informacionit, të lajmeve të rreme e të post truth (rastit kur nuk kanë rëndësi faktet, por çfarë emocioni shkakton me "argumentet" e tua)

- beteja me shpifjen i ngjan pak betejes me mullinj të erës. (Megjithëse sot mullinj të erës janë burim i pastër energjie)

Shpifja e ka përgjigjen në ligjin ekzistues. Ajo çfarë vjen *off line*, vjen edhe *on line*. Një vendim i mirë gjykatë, një vendim që merr në konsideratë dhe peshon të drejtën e informacionit, të drejtën për jetë private dhe interesin publik, shërben më shumë se 100 kode etike. Ligji shpifjes nuk është vetëm për median. Media është lule krahasuar me...politikanët apo jo?!

Kodi etik i gazetarëve (i ripunuar së fundmi) është mjaft i qartë në deontologjinë e profesionit, por ndikimi i tij në praktikë i ka ngjarë efektit që kishte dikur urdhri i oficerit ndaj ushtarit një ditë para se ky i fundit të lirohej nga ushtria.

Shqipëria ka mbi 20 gazeta të përditshme, 56 televizione, mbi 200 kablloër, mbi 700 portale, mbi 1.8 milionë llogari 'Facebook'. Dhe gjithë këto operatorë mediatik - janë në një treg që nuk funksionon si treg.

Sigurisht kryeministri dhe qeveria mund të bëjnë shumë për lirinë e medias. Rastet e dhunës ndaj gazetarëve duhen hetuar me shpejtësi me përparësi dhe duhet dërguar sinjali i qartë që me

gazetarët nuk bëhet shaka.

Kryeministri do të jepte një kontribut të madh për lirinë e gazetarëve nëse nuk do të shkonte në asnjë televizion nëse Inspektorati i Punës nuk do të certifikonte që gazetarët janë me kontrata dhe paguhen rregullisht. Ka tv që qëndrojnë hapur vetëm për të pasur në studio kryeministrin / ministrin e radhës.

Kryeministri do të ndihmonte shumë në lirinë e medias nëse do të jepte një urdhër të qartë që mos zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit (një nga ligjet më të mira që kemi) është krim i ndëshkueshëm.

Kryeministri do të ndihmonte në pastrimin e diskutit publik nëse në Parlament, ata që ka nën hyqëm të zbatojnë kodin e etikës dhe të kenë minimumin e njerezilëkut në komunikimin publik.

Shpifja është pjesë e lirisë së shprehjes - JO e lirisë së medias.

Kryeministri është në detyrën e lartë edhe për të duruar. Ka plot që e konsiderojnë lirinë e medias si "leje gjuetie", por teprimet në lirinë e medias janë çmimi që një shoqëri paguan për të qenë e lirë.

Media ka kusuret e veta, por më mirë një media që "shpif" se një qeveri që kumon se çfarë është e vërtetë dhe çfarë është e gënjeshtër?!

Skenari Huxley nuk luftohet me "skenarin orëllian". Nuk ka nevojë për ndallime të reja. Ka nevojë për shtet ligjor që funksionon. E fillon dot i pari kryeministri? E nis dot me hapin e parë - ndarjen/distancimin nga oligarkët e medias që rrënojnë rregullat e profesionit për ca para buxheti më shumë?!

HOROSKOPI

DASHI

Sot intuita nuk do t'ju lërë në baltë. Do të arrini që me sukses të mësoni taktikat e armikut. Me financat nuk do të kenë probleme të mëdha.

DEMI

Sot intuita nuk do t'ju lërë në baltë. Do të arrini që me sukses të mësoni taktikat e armikut. Me financat nuk do të kenë probleme të mëdha.

BINJAKET

Mund të përballemi me disa surpriza të këndshme në punë. Disa kolegë do ju vlerësojnë shumë tek eprorët tuaj. Sa i përket dashurisë, diçka e re duket në sfond.

GAFORJA

Ditë e mbarë për të lindurit në shenjë tuaj. Do të vlerësoni çdo gjë me kujdes, duke shpresuar se do kaloni pengesat e mundshme. Me paratë gjithçka do ju ecë mirë.

LUANI

Ditë e mbushur me adrenalinë do jetë kjo e sotmja për të dashuruarit. Largohuni nga ambienti i zakonshëm, për të zgjeruar njohuritë tuaja diku tjetër.

VIRGJERESHA

Përpuni që të pushoni dhe të qetësoheni më shumë. Nëse nuk i jepni vetes më shumë energji, çdo gjë do të përktëhet në stres dhe ankth.

PESHORJA

Përgjithësisht e gjithë kjo periudhë do të karakterizohet me fat për të lindurit në shenjë tuaj. Personat që nuk janë në një lidhje dashurie, do të mund të kenë një shkëndijë.

AKREPI

Financat parashikohen të mira nëse keni investuar në burse apo edhe nëse paratë i keni në bankë. Parashikohet të merrni një dorë të mirë parash.

SHIGJETARI

Ka qenë një periudhë e mbushur me ankth dhe stres, por gjithçka do të normalizohet brenda pak ditësh. Në planin financiar duhet të ndryshoni mënyrën e menaxhimit.

BRICJAPI

Nëse jeni duke menduar mbi një projekt gjasat janë që nuk do të realizohet. Mos u mërzisni sepse nëse merrni më shumë këshilla mbi këtë projekt, gjërat edhe mund të ndryshojnë.

UJORI

Ditë e mbarë për të nisur një aplikim për punë. Sigurohuni që të jeni korrekt me plotësimin e formularëve. Në dashuri gjendja nuk do jetë ashtu si ju e keni pritur.

PESHQIT

Prej kohësh ju shqetëson një çështje dashurie. Komunikimi është i domosdoshëm për të kuptuar se çfarë po ndodh në raportin tuaj. Të paktën do të ndiheni i qetë me rezultatin.

MBROJTËSI KUQEZI



Te Napoli nuk janë të kënaqur me formën që po tregon Elseid Hysaj dhe në mediat italiane, thuajse çdo ditë ka emra që dalin në skenë për të zënë vendin e futbollistit të përfaqësues shqiptarë. Rinovimi i tij nuk po bëhet realitet dhe thuajse të gjithë duken të sigurt se Hysaj mund t'i japë së shpejti lamtumirën napolitanëve në fund të këtij sezoni. Shpesh janë

Hysaj është në treg, Napoli kërkon tjetër lojtar

përfolur emra skuadrash të ndryshme të interesuara për shqiptarin, por duket se napolitanët duan që të gjejnë një zëvendësues sa më të mirë për Hysajn para se ta lënë të largohet. Ndaj së fundmi po shihen alternativa nga më të ndryshmet dhe emrat që qarkullojnë

janë ato të mbrojtësve të djathtë të Çelsit e Manchester Junatjid, italianët Zapakosta e Darmian, të cilët duan të kthehen në Itali. Në mediat italiane mendohet se tashmë Hysaj mund të përdoret si "objekt shkëmbimi" kokë më kokë me një nga futbollistët e

mësipërm, me klubin përkatës anglez që do të ishte i detyruar edhe të paguante një shifer të caktuar parash për diferencën, meqë mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare vlerësohet më shumë se dy lojtarët italianë. Mbetet të shihet në vijim, por sipas sinjaleve që vijnë nga Italia, e ardhmja e Hysajt është gjithnjë e më shumë larg Napolit.

Në Korçë gjërat nuk po ecin siç duhet. Lojtarë të pamotivuar dhe KAS-i që po zvarritet

Skënderbeu del në stërvitje, lojtarët me sytë nga bankomati

Klubi s'garanton asgjë, pret përqindjet e shitjeve



Jeton Selimi

Te Skënderbeu ka një çështje, ose më saktë ka disa çështje që së bashku e bëjnë mjaft të turbullt qiellin mbi Korçë, duke rritur shumë dyshimet e tifozëve rreth asaj që do të jetë e ardhmja e klubit bardhek- uq. Kjo sepse për herë të parë që prej vitit 2010 te Skënderbeu ka probleme financiare. Diçka e tillë duket një e shkuar e largët, në kohën kur Agim Zeqo dhe Ardjan Takaj nuk kishin zbankuar ende në Korçë për të marrë kontrollin e klubit që më pas do të dominonte futbollin shqiptar, pavarësisht polemikave që e kanë shoqëruar gjatë kësaj periudhe. Dje lojtarët e Skënderbeut kanë dalë në stërvitje të heshur dhe kokullur. Ata e kanë pasur mendjen ende te rrogat e prapambetura, ndërsa nga ana e klubit nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar në lidhje me këtë situatë, madje ç'është më e habitshme as nuk kanë reaguar publikisht për këtë ngjarje. Ajo që mësohet nga burime të afërta me klubin bardhek- uq, është se presidenti Takaj po pret përqindjet e shitjes së Peter Olainkës dhe ndonjë lojtar tjetër për të krijuar kapitalin e nevojshëm për të



siguruar përfundimin e sezonit. **NË PRITJE TË KAS-it** Pasiguria duket se do të vazhdojë gjatë, pasi nuk ka ende asnjë datë reale për

zhvillimin e seancës dëgjimore në KAS të Lozanës që do të përcaktojë fatin e klubit korçar. Fillimisht mendohet se gjyqi do të zhvillohet në shtator, rreth katër

muaj pas vendimit të dalë nga UEFA, e më pas në tetor, siç janë shprehur drejtuesit më të lartë të klubit. Por një gjë e tillë nuk ndodhi, ashtu siç duket se nuk do të ndodhë edhe gjatë nëntorit. KAS i Lozanës ka publikuar sot datat e reja të shqyrtimit të çështjeve që do të trajtojnë së afërmi dhe deri në fundit të nëntorit janë regjistruar 19 çështje, të cilat do të merren në shqyrtim. Asnjë prej tyre nuk është ajo mes Skënderbeut dhe UEFA-s, që do të thotë se edhe për muajin nëntor nuk do të ketë asnjë të re në këtë drejtim. Në një kohë kur të gjithë lojtarët deklarohet se presin vendimin e KAS për të vendosur se çfarë do të bëjnë në të ardhmen, në radhët e klubit korçar shtohet pasiguria dhe nëse vendimi nuk del para mbylljes së vitit, në janar mund të përjetohet një tjetër eksod nga radhët e kësaj skuadre.

NDESHJA KUNDËR MILANI



Çmime të çmendura, ultrasit juventinë kërcënojnë me bojkot

Tifozët e Juventusit po mendojnë të bojkotojnë udhëtimin për në San Siro. Milani do të ndeshet me Juventusin në 11 nëntor dhe çmimet për bileta në sektorin e miqve shkojnë deri në 75 euro. Kjo ka shkakuar zemërimin e ultrasve bardhezinj për shkak të rritjes së çmimeve. Sipas asaj që raporton "Tuttosport", tifozët e Juventusit kanë paralajmëruar bojkot. Gjithashtu, edhe në stadiumin e Juventusit çmimet e biletave janë rritur; por tifozët vendas nuk kanë protestuar.

SUPERLIGA		
JAVA E 9-TE		
Të shtunën		
Kastrioti - Kukësi		14:00
Laçi - Teuta		14:00
Të dielën		
Skënderbeu - Kamza	14:00	
Partizani - Luftëtari	17:00	
Të hënën		
Flamurtari - Tirana	18:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	8	19
Skënderbeu	8	17
Laçi	8	16
Kukësi	8	13
Flamurtari	8	11
Teuta	8	11
Tirana	8	8
Kamza	8	7
Luftëtari	8	6
Kastrioti	8	4

Peshëngritësi, me sytë nga qeveria

Calja ngre zërin: Ende nuk kam marrë shpërblimin e merituar



sohet më shumë te sporti. Kam dalë kampion më me 26 mars dhe shuma që duhet të marr është 3.4 milionë lekë

të reja, gjithashtu, nuk jemi të siguruar. Ne nuk jemi sportistë amatorë, por jemi të nivelit të lartë", tha Calja.

Kampioni i tri medaljeve të arta në Kampionatin Evropian të Rumanisë në shtangë, Brikën Calja deklaroi për "Ora Neës", se nuk ka marrë akoma shpërblimin që i takon nga suksesi në Bukuresht në mars të këtij viti. Gjithashtu, ai ngriti edhe një tjetër problem: ai dhe të gjithë sportistët si ai nuk janë të siguruar. "Sot e kësaj dite nuk kam marrë akoma shpërblimin që më takon me ligj. Kam dalë 1 herë kampion europe dhe kam marrë tri medalje ari. I bëj thirrje shtetit ta shohë me vëmendje pjesën e shpërblimeve dhe Bashkisë së Tiranës që të foku-

HUMBIA ME ANGLINË

Mëria e Spanjës, Buskets gjuan me top gjyqtarin


Serxhio Buskets është shpesh në listat e futbollistëve më të urreyer për shkak të simulimeve të famshme të tij në periudhën e rivalitetit të ashpër mes Real dhe Barcelonës. Mbrëmë, futbollisti i Spanjës mund të ketë fituar disa armiq më shumë pas asaj që bëri në fund të takimit kundër Anglisë, ku përfaqësuesja e tij u mund me shifrat 3-2. Kur gjyqtari polak Marciniak i dha fund takimit, ai u rrethua menjëherë nga disa futbollistë spanjollë, të cilët protestuan për vendimet që kishte dhënë në këtë takim, shumë prej të cilave jo në



favor të tyre. Ndërsa lojtarët e tjerë protestonin, Buskets lëshoi topin me forcë drejt gjyqtarit, një veprim i cuditshëm po të llogaritësh se mesfushori është mësuar të

luajë ndeshje të tensionuara edhe në nivele të tilla. Futbollisti ishte përplasur disa herë me Marciniak gjatë takimit për vendimet e gjyqtarit, e me sa duket në fund nuk e kanë mbajtur nervat. Gjithsesi, ai vrau menjëherë duke i kërkuar falje e duke i shpjeguar se e kishte bërë pa dashje, pa qëllimin për ta goditur atë. Megjithatë, nëse gjyqtari e ka shënuar këtë sjellje në protokollet dhe nëse pamjet filmike e konfirmojnë se është bërë me qëllim, Buskets rrezikon një dënim shtesë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Eshhtë stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kujfij
17. Parashtesë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Eshhtë si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Eshhtë me shumë se kërkese.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të pritjes.
35. Gjysmë batakua.

36. Eshhtë për medaljen e parë
37. Eshhtë kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenisnike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kujfij

VERTIKAL

1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Eshhtë pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoque.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Eshhtë thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'stria e Helena Gjikës
12. Smith filozof.
13. Kujt regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Moduli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolete.
20. Mbyllit fushatat.
21. Eshhtë dorëzim.
22. Eshhtë detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Eshhtë hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nnganjëherë duhen vënë mbi.
33. E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


34. Janë thënie e famshme.
35. Janë trupa qellore të tillë.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në computer
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Eshhtë e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Eshhtë thesar.
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhet për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstreme në tunel.
21. Një atentator vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
29. Eshhtë aparati me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.
45. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2			9			
7				4		6	3	
		4	9	5		7		1
								9
					3			7
		1				8	2	
3	2		5	9				
5	6							
		8				3	7	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Argëtim filozofik

-Njeriu dëshiron madhësinë dhe famën, trembet nga mospërfilija; megjithëkëtë nuk largohet nga sjielljet e këqija; kjo është si kur ke frikë nga lageshtira e banon në moçal.

-Po të jenë nëpunësit në dorë të personave të pazotë, po t'u mungojnë armët ushtarëve, po të mbetet pas buqësia, mjeshtëria dhe tregtia, prapë-prapë shti qëndron; por kur sundimtarët nuk respektojnë ligjin dhe të drejtën, nëpunësit e vegjël bëhen të pabindir dhe nuk zbatojnë urdhrin e dhënë, kështu që populli bjer vetitë e mira dhe jepet pas veseve të këqija, atëherë nuk ka më shpresë shpëtimi.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11	5	9	6	11	1	4	3	B	A	S	T	E	T	P	A	P	A			
12	16	15	17	6	11		15		4		12	2	U	R	A	T	U	R	H	P	A			
6		1	4	12	6	11		5	18	11	2	9	S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I	
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3		T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
2		1	7	3	2	9	7	9	2	3			P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T
14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3			G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R	
18	4	6	9	8		1	12		7	9			B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T	
9	2	12	2	4	12	3	9	2	18				S	A	L	I	R	A	M	A	L	E		
4	8		2	3	8	6	6		6	16	15		G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R	
5	K	4	12	3		11	2	5		3	6	12	A	R	E	S	A	O	E	N	E			
15	U	3	6		1	2	3	4		5	2	11	2	Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T
17	J	9	9	15	16	4		4	9	3	2	3	I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Mos i poshtëroni njerëzit e mëdhenj për një a dy faje të tyre, sepse diamanti sado i prerë shtrembër të jetë, është më i vlefshëm se një gur i zakonshëm, i prerë në formën më të përsosur.]
- Mashtimet e mashtuesit i përballon me drejtësi, sepse gjithçka mënjanohet me të kundërtën.
- Njerëzit janë të njëjtë para natyrës, edukata i bën të dallohen (njëri nga tjetri).
- Fjala e atij që qesh shumë, s'e bën të qeshë asnjërin.

